

BIBLIOTEKA

85H-32

1999

# Partizan Myftari

## NATA E VETME

TREGJIME



834-32


1999

# Partizan Myftari

## NATA E VETME

Tregime

54286



Shtëpia Botuese  
e Lidhjes së Shkrimtarëve

## SA PAK RRON NJERIU!...

Gushti është në ditën e pestë. Rolandi ende pa lindur dielli ngrihet e bën fiskulturën e mëngjesit bregut të qetë të detit. Rërën gjithë natën e kanë lëpirë dallgët e kripura dhe i kanë fshirë të gjitha gjurmët e një dite të shkuar. Gjurmë të freskëta, por të rralla janë vetëm ato të njësiit ushtarak që vëzhgon bregdetin kufitar. Dallgët janë përpjekur t'i lëpijnë edhe ato, por ende s'i kanë zhdukur. Rolandi vrapon lehtë dhe shkund dremitjen. I dukej se ishte larg halleve të rëndomta dhe ato pak pushime që i kishin mbetur donte t'i shtynte pa menduar për çka kishte lënë mbrapa. Dhomën ia kishin zënë kushërinjtë e parë nga qyteti i Lushnjës dhe së bashku kalonin gjithë ditën me letra, futboll e më pak lexonin libra. Rolandit i pëlqente vetmia dhe kundrimi i pafund i dallgëve, që nxirrnin në breg guaska midhjesh e mbeturina të lehta.

Ditën e pestë dielli dukej se do të ishte më i nxehtë. Çdo ditë i shtonte krosit rreth dyqind metra dhe sprintin e fundit e bënte më të gjatë dhe më të fuqishëm. Përherë ishte i pari dhe i vetmi që e bënte krosin pa u takuar me askënd e fillikat, pranë mërmërimës së dallgëve dhe gjurmëve që i fshiheshin menjëherë, sepse ai vraponte më shpesh me këmbët brenda ujit të kripur. Përkëdhelej me dallgët. Edhe këtë mëngjes kështu po rendte, kur

para tij ecte një plak me takije të bardhë, i gjatë, pak i kërrusur dhe me një xhaketë doku të kaltër, që i ishte zbardhur fare. Ishte e njëjta orë si ditët e tjera. Plaku nuk bënte kros si ai, por ecte si të kishte gjithë natën që udhëtonte në atë bregdet të qetë të asaj dite gushti. Mbas shpine mbante një çantë të zezë prej doku. Pantallonat e plakut ishin prej doku bojëdalë. Fytyrën ende s'ia kishte parë. Me një shkop kallami në dorë, dukej se numëronte hapat e vetvetes. Ç'hapa ishin ato që ngjeshnin aq ngadalë rërën mëngjesore?...

Rolandi afrohej gjithnjë e më tepër, plaku sikur dremiste më shumë. Ecte pa e kthyer kokën asnjëherë pas.. I dallonte gjithnjë e më shumë kon-turet e trupit të tij. Vinte i dobët. Edhe nga kërcinjtë ashtu ngjante, thatim e pak i krrusur. Plak myzeqeje tha me vete Rolandi. Lalë. I kaloi në krahë dhe i tha një «mirëmëngjesi» pa e ndalur hapin fare. Ai s'foli. Duket se nuk dëgjoi mirë, por as Rolandi nuk e ktheu kokën pas. Kur i kaloi në krah, shkarazi, dalloj se edhe fytyrën e kishte të thatë, me rrudha. Tani ishte plaku që ecte pas. E linte gjithnjë e më mbrapa duke e shtuar ritmin, pasi ishte në metrat e fundit. Vraponte mbrapsh, krahash, për të vënë në lëvizje gjithë muskujt e trupit. Plaku dukej tani nga larg si njëllë lëvizëse.

Rolandi kthehet për tek vendi i zakonshëm, ku bënte ushtrimet gati për pesëmbëdhjetë minuta. Nga lindia, qielli ishte përflakur dhe rrezet e para kanë puthur larg kaltërsinë e detit që merr ato çaste ngjyrë të argjendtë. Sytë ndiejnë nevojë të shplodhen mbi atë hapsirë që përndizet gjithnjë e më tepër me ngjyrën e argjendtë. Plaku, që ç-

ste më parë dukej njollë nga larg, u afrua. Ishte i heshtur, hapdremitur e fytyrëlodhur. Rolandi bën ulje-ngritje me muskujt e fuqishëm dhe lakuriqësia e trupit prekte rërën e ftohtë. Plaku e shikon si të mos ia fërshëllente se ç'qe ai mjekërrosh e flokëgjatë. Duket se ai s'ka nge të merret me të. E shikon si me dyshim po pastaj i ndërrohet mendja. I hipën një frikë. Ka shumë turbullira sivjet, thotë plaku me vete. Këtyre flokëgjatëve çfarë nuk u pjell ajo bushtër mendje. Plaku kalon e lë një hap pas Rolandin.

— Mirëmëngjes, xhaxha!

— Mirëmëngjes, djalë! — dhe vazhdon rrugën.

— Po bën fizkulturën e mëngjesit?!

— E, e...

Rolandi i shikon tumanet prej doku, xhaketën e zbardhur dhe jakën e grirë të këmishës së bardhë, që është andruar pa kujdes.

— S'të paska blerë plaka brekë plazhi, o xhajë? — e ngacmon Rolandi pa i lënë ushtrimet mbi rërë. Plaku heshti e s'dinte si t'ia kthente përgjigjen ngacmuese djalit të panjohur.

— M'i bleu, djalë, por u grisën me kohë.

— Të tjera. Plaka një plak ka.

— Edhe të tjerat i kam porositur...

Pas disa minutash u miqësuan. Plaku u ndal aty te këmbët e tij dhe shikonte djalin që vinte gjithë trupin në lëvizje me shkathtësi. Nisën të flisnin. Qenkësh pak tip shakaxhiu plaku, por vet s'qeshte. Fliste pak dhe të shikonte në dritë të syrit. Ishte divjakas denbabaden. Rolandi kureshtar e pyeste dhe ai përgjigjej fare ngadalë. Ai e pyeti Rolandin nga ishte dhe ky i tregoi për qytetin e tij e më pas për fshatin ku banonte. Plaku e pyeti për punën.

Rolandi nuk i tregoi se punonte si mësues në një shkollë të mesme. Zakonisht Rolandi kurrë nuk rrëfehej gjer në fund. Diçka e ruante nga të gjithë... Plaku divjakas fliste me një myzeqarçe të pastër. Tregoi se ishte shtatëdhjetëkatër vjeç. Shtatëdhjetëkatër. Aq vite e kishte parë edhe detin e Divjakës, që ato çaste ishte i qetë. Tregon se kishte mbatur fillikat. Bënte mbi pesë vjet që rronte i vetëm. Katër fëmijë të martuar. Aq kishte. Dy djem e dy vajza.

— Pa më thuaj, pse rron vetëm? — çuditet Rolandi. Plaku i ndërron krahun çantës së zezë që mban në krah...

— Nuk e qasin babën në shtëpi djemtë.

— Pse?

Divjaksi hesht. Sytë nga deti i hedh rrallë, si të jetë ngopur me të dhe s'ka nevojë t'i shohë as bojën. Ai e ka parë detin në çdo stinë. Det të dashuruar e det të tërbuar. Rolandi është e kundërtë e tij. E sheh etshëm. Ndien. Ndien dallgët, ujërat e qeta e deri më tej, reflekset e diellit. Rolandi e ka për herë të parë që e sheh këtë bregdet. Në stinën e dimrit nuk ia ka parë kurrë zemërimin.

— Kur më vdiq grueja mue...

Më dëgjon?! Rolandi i hoqi sytë detit të shndritshëm dhe i zbrazi mbi plakun e lodhur.

— Të dëgjoj, o xhajë.

— Kur më vdiq grueja mue... Më dëgjon? Me kancer e kisha. Kanceri ma mori dhe ma mbylli derën. U thashë djemve. Më dëgjon? U thashë djemëve, se baba po gjeti ndonji grue tjetër të moshës... Do të martohet prapë baba. Kështu u thashë. Më dëgjon?

— Po xhaxha, — ia ktheu Rolandi dhe me të

vërtetë po e dëgjonte me vëmëndje. Ai fliste tani më i kujdesshëm, si të kishte nevojë t'i rrëfehej dikujt e të ndihej më i qetë. Rolandi s'e kuptonte në rrefehej atij apo detit. Sigurisht mua, vazhdonte me vete Rolandi. Këtij deti plaku do t'i jetë rrëfyer gjithëherë; edhe kur ka qenë me trazime dimërore, edhe kur dukej se fiinte në shtratin e vet kastile për të dëgjuar rrëfimin e plakut...

— Po djemtë? — pyeti Rolandi.

— Djemtë u idhnuen kur e morën vesh e s'më qasën në shtëpi. Kështu mbeta vetëm. Eh! Vetëm...

Ai tregoi se një djalë e kishte inxhinier nafte në qytetin e Lushnjës, me shtëpi e tjetrin tek themeli i shtëpisë së vet. Ky i themelit kishte njëzet vjet martuar dhe s'e bënte për hall t'i zgjaste dorën e ta fuste brenda të atin.

Vazhduan të ecnin. Plaku divjakas quhej Tasi. Rrëfente e rrëfente si ta ndiente se vetëm ashtu mund të çlironte shpirtin. Flokët, mjekrra e mustaqet e rritura të Rolandit tani plakut nuk i dukeshin më të frikshme. Pranë kishte një djalë që e dëgjonte dhe e ndiente... Tasi ndonjëherë e lajthiste bisedën pa dashje. Djalit i qeshej. Rrugën e kthimit, drejt kabinave të plazhit tani e bënin bashkë. Rolandi ecte sipas ritmit që kishin hapat e Tasit. Djali kishte kohë edhe të shplodhej, edhe të kundronte detin e qetë. Det pa dallgë. Plaku një det më vete. Ishte i qethur shkurt dhe mbrapa i zbulohej zverku me lëkurë të dobët e gjithë pulla.

— Domethënë ti kërkove të martohesh?! — e pyet Rolandi dhe vëren tiparet e tij. Ndonse di si i rregjuar, ende ruan tiparet e burrit që ka forca.

— Do të martohesh xhaxha?!

— Posiii, — shton gjithë zjarrllëk Tasi. — S'rro-

het pa grua, djalë. S'ka më keq. Ajo të lan, të bën gjellë, punë, llafe, muhabet. S'ka më keq se pa grua. Më dëgjon?!

— Të dëgjoj.

— Ti je fejuar?

— Jo.

— Ala, o djalë?!

— Jo, jo.

— A a a! Po ç'bën?!

— S'duan, — qahet kot së koti Rolandi për të ngacmuar më tej plakun që s'rronte dot pa grua.

Tasi s'pyeste. Ndaloj hapin e foli i zemëruar.

— A a a! Gjej ndonjë çupë të bukur dhe... dhe fshtete gjëkundi.

Dielli sapo ishte shfaqur si top i zjarhtë nga lindja dhe derdhte rrezet. Njerzit në breg janë shtuar për të bërë shëtitjen e mëngjesit. Në krah të Tasit kalon një vajzë, që bënte çdo ditë kros. Ishte me rroba banje. I ka të bukura, por edhe trupin të derdhur. Gjoksi i bëshëm i tundet, kofshët gjithë ngjyrë çokollatë i ka të gjata, të drejta gjithë musklaturë. Bën disa lëvizje plot elasticitet dhe fytyra i rri e qeshur. Flokët i mban të lidhur. Rolandi vetëm në fizkulturën e mëngjesit kishte arritur ta shikonte. Në rërë asnjëherë. Vetëm dinte që ajo ishte e bukur dhe asgjë më tepër. Po dinte që në krosin e mëngjesit nga pas e ndiqte dhe i ati. E ndiqte, veçse gjithmonë pak metra larg, sikur donte të ruante sytë që mund të lakmonin vajzën e tij të bukur... Ato çaste, kur kaloi prënë tyre, Tasi e pa më i etur se djali. Ktheu kokën pas dhe ndoqi lëvizjet e saj disa minuta. Atë që duhej të bënte Rolandi e bën Tasi. Djalit i qeshet. «Ç'plak ruffjan!» thotë me vete.



— Ulemi këtu! — lutet plaku.

— Pse?

— Ja, sa të kthehet ajo çupëlina që iku tani.

— Ajo?! Ajo shkon larg. Ajo nuk kthehet këtej, — i përgjigjet Rolandi.

— E njeh? — pyet plaku.

— Jo.

— Ah, ah!... — brengoset ai. — S'u kthyeka, — dhe ktheu kokën, si ta shihte për herë të fundit largimin e saj.

— Të pëlqeu?! — e ngacmon Rolandi.

— Mua?! Mollë që s'e kafshoj dot. Ja. Një, një si kjo të kesh ti. Je djalë në vaktin tënd. Pa ta mbërthesh njëherë. Ah! Pa, pa si ndizet. Të dy zjarr merrni dhe as deti nuk e shuan dot. Plazhin do të na përvëlioni.

— Vetëm kjo mos ndodhtë, — ngacmon Rolandi me të qeshur.

— Aman digju njëherë, pa...

Plaku i tërhoqi sytë nga vajza që u zhduk bregut që mbushej gjithnjë e më tepër. Ai filloi përsëri të fliste.

— Se, që thuaj ti, s'ka më keq se pa grua. Fliste si gjynahqar. Na qenkësh erotik i madh xha Tasi dhe Rolandi ende s'po e kuptonte erotikën e tij. Përse vuante?! Për grua në krevat, apo për femra që të bënte qejf?!

Vazhdonin kthimin. Tasi herë pas here i ndërronte krahun trastës që mbante bukën. Kishte aty një shishe kosi dhe pak bukë. Atë ditë do të kalonte në plazhin e nxehtë, ndaj kishte ardhur dhe herët. Ecnin në rërën e lagur dhe ajrin e pastër. Tutje nga ujrat e thella çau një motoska. Heshtën të dy duke ndjekur dallgët që la nga pas motoska.

— Ke punuar? — pyeti Rolandi.

Plaku iu përgjigj me një «po» gati të heshtur.

— Sa e ke pensionin?

— Tremijë e dyqind lekë.

— Të vjetra?

— Eee.

— Ke lekë në librezë?

— Një pakicë, — përgjigjet me bezdi si të mos i pëlqenin biseda të tilla.

— Sa?

— Afër njëqind mijshes.

— Të vjetra?!

— E, me të vjetra flas unë, — sqaronte ai dhe ndiqte me sy femra me gjokse të bëshme, gra me trup të këndshëm e plaka që e mbanin trupin drejt. Ashtu si ndiqte Rolandi valzitjet e detit e tregohej i pangopur. Tasi ndiqte me sy femrat. Kënaqej dhe psherëtinte pastaj i pafuqishëm.

— Ah, të kisha moshën tënde, vaktin tënd.

— E çë pastaj?!

— Dija unë si merresha me to. Jo vitet s'do t'i lija të më vdisnin, por as ditët.

— Të fal unë disa vite. I merr? — e pyeti me shaka Rolandi.

— S'është punë ajo. Ato vite që ke s'të dalin për vete.

— Po ty të kanë dalë?!

— Jo.

— Pse?!

— Njeriu, sa do që të rrojë, gjithmonë është pak.

Pranë tyre kaluan dy vajza. Njëra tamam tek të gjashtëmbëdhjetat, me trup e zhvillim të bëshëm, tjetra e vogël. Tasi ndoqi me sy gjashtëmbëdhjetë-

vjeçaren dhe i shkelte syrin djalit. Vajzat i lanë pas.

— Ti je martuar? — e pyeti Rolandin përsëri.

— Jo.

— Pse s'martohesh?

— S'kam qejf.

— A je burrë për atë punë?

— Ç'punë?!

— Që ta fshtetësh femrën në ndonjë rrëzë.

— S'po të kuptoj, — hiqej i paditur Rolandi.

— I ke të gjitha allatet si mashkull?!

— I kam.

— E po martohu. S'ka më keq se pa grua. Ja, unë s'po gjej ndonjë. Njeriu rron gjithnjë e më pak sa do që të rrojë shumë. S'po gjej ndonjë grua. Edhe dyzet a pesëdhjetë vjeç të jetë, e marr. S'gjej. U bëra si ajo pema plakë e mbetur kërcu, që prodhon pak e s'i hipën njeri se kanë frikë nga degët e thata... Më sheh mua Tasin?! Edhe ndonjë femre i kam thënë. Hajde me xhajën, shtyjmë disa minuta si në shpirt të perëndisë. S'duam, thonë.

Tasi sa herë që flet duket se vuan me të vërtetë për një grua. U afrohen gabinave edhe më. Tasi vetëm për ksi punësh rrëfen. Zëri i hollohet e duket se rrëfen gati duke qarë. Ndalon. Shikon prapë shishen e kosit përzier me ujë. Nga larg ai rrëfen edhe vendin ku do ta bëjë plazhin e ditës. Rrëzë një bunkerit të madh që vështron gjithmonë drejt kaltërsisë paqsore të detit. Tek bunkerit rëra ishte e pastër. Zhurma që e largët prej andej. Rolandi e kuptoi nostalgjinë që ndiente xha Tasi për vitet e shkuara. Shikon çifte të rinjesh dhe ia ndalon rrëfimin djalit. Ndjek ecjet e tyre. Kur kalojnë çifte veshur vetëm me rrobat e banjës, mendohej që në veprimet, pëshpërimat e tyre, mos zbulonte diçka.

Ndiqte edhe lëvizjen e dorës se mos ajo jepte shenja të një seksualiteti ndezës. Një djalë bjond e shtatë lartë, veshur me rroba banjo, ia varte pëllëmbën e vet vajzës mbi gjoks, thuajse brenda rrobave. Femra ia mbulonte nga ana tjetër me dorën e vet dhe ecte gjunjë këputur.

— Ja. E sheh? — ngacmonte xha Tasi Rolandin.

— Çfarë?

— E sheh si i ka mbështetur dorën?! — dhe e ndiqte me sy gjersa çifti humbiste. Pastaj i kthehej Rolandit. — Jo, po me grua, me nuse, me të fejuar ka sevda njeriu. Ah, ç'më bëri ajo qyqe mua! Ma hëngri kanceri! Ah! Po ti je fejuar? — e pyeti Rolandin për herë të tretë.

— Jo.

— Nuk ia ke dhënë fjalën ndonjërës?! — s'i ndahej ai.

— Ia kam dhënë.

— E ke në plazh?! Oh sa mirë kaloke me të.

— Jo. Nuk e kam.

— Jo?!

— E. Ajo imja është e vogël. Pesëmbëdhjetë vjeçare.

Ai ndalon. Kërkon rreth e rrotull me sy, se mos shikon ndonjë pesëmbëdhjetë vjeçare e t'i bëjë krahasimin Rolandit. Por Rolandi e kishte bërë ditë më parë këtë punë. I kish rënë plazhit që nga Draga e gjer tek derdhja e kënetës nga ana veriore. Veç një elbasanse i afrohej. Shembyllturë tjetër s'gjendej. Elbasansia dilte vonë në plazh. Ajo ishte vetëm një vit më e madhe.

— Ah! — vazhdoi habitjen Tasi me inatin që ato minuta nuk kaloi një pesëmbëdhjetë vjeçare,

por vetëm gra të martuara dhe plaka. — Aha! E paske kërce fare, A po ka hedhur trup? Se ajo zona juaj i bën femrat. I bën uji.

— Njomzake është, — sqaroi Rolandi dhe hodi vështrimin mbi detin e qetë si të ndodhej njomzakia e tij atje e ta ftonte të luanin me valët e qeta kaltëroshë.

— E ke fshtetur ndonjëherë? E ke puthur? — pyeti ai Rolandin dhe nuk ia hiqte sytë si të zbulonte të vërtetën. Xha Tasi e paska keq me të fshtetur, tha me vete Rolandi.

— Hë! E ke fshtetur?

— Jo.

— Pse?

— Timen e kam. Kur të dua...

Ai mblodhi buzët si i vuajtur me këto punë.

— Mos të thotë që jam e vogël?

Xha Tasi e kishte gjetur. Pesëmbëdhjetëvjeçarja ashtu i pati pëshpëritur në fillim tek veshi me gjithë përskuqjen e saj të mundimshme.

— Hë?! — e zgjoi xha Tasi.

— Edhe do të rritet...

Tundi kokën si t'i thoshte «Qënke budalla, djalë!»

— Posi, o posi... Ti i thuaj ta shtyjmë sot aq sa je, pastaj shohim e bëjmë.

Rolandit i qeshet. Plaku erotik rrëfen edhe për vetminë e tij. Shërimin e ndiente vetëm te jeta bashkëshortore. I tregoi Rolandit edhe për pasurinë që ia kishte marrë dikur qeveria, gjithë atë tokë dhe së fundi kishte mbetur i vetëm. Rolandi ndiqte rrëfenjën e tij që e ndërpriste kur kalonin çiftet dhe vajza të reja. «Do të ketë qënë çift i mrekullueshëm që e kanë kuptuar shumë mirë njëri-tjetrin», mendonte Rolandi. E pyeste dhe xha Tasi përgjigjej.

Nuk i pëlqente të ndahej nga Rolandi. E kishte nevojë shpirti i tij të zbrazej me një njeri, kur s'ka mundur të gjente një tjetër. Tek shtëpia atë e ndiqte vetmia si rrobe e vjetër. Rolandit i vinte keq që të ndahej ato çaste. Ndonjëherë zëri i tij të kujtonte një vuajtje të thellë në shpirt dhe s'do ta kishte për gjë të qante ato çaste. Sa më shumë ta pyeste Rolandi për punë femrash e grash (dukej se plakū aty e donte bisedën) ai ishte gati të mbannte hapat, të fliste dhe të ndalonte çfardo lloj fjale, kur para tyre kalonin femra të bukura me rroba plazhi. Aty, para se t'i afroreshin bunkerit, ku ai do të kalonte orët e pesë gushtit të nxehtë, Rolandi e pyet:

— Xha Tasi! Veç me gruan tënde je marrë? Po me të tjerat?!

— Unë?

— E.

— Sa isha i ri jo. Nuk dija shumë gjëra. Se të shumtat tani në pleqëri i mëson, por të vjen keq që s'i bën dot të gjitha. Jam ajo pema e plakur që frutat e pakta i bën të mira, por s'hipin t'ia marrin, se ka degë të thata. Se njeriu sado që të rrojë, rron gjithmonë pak. Ti thua të më jepje vite borxh, por ty as për vete s'do të dalin, asnjëherë. Se mos më mjafton mua. Rrojmë pak ne të shkretët njerëz, rrojmë pak. Kur u martova, tu, tu, e kisha edhe nusen time, u mora me nja dy gra. Njëra ishte aty tek të pesëdhjetat. Më hidhte vet rromuze. Me sa duket nuk shkonte mirë me të shoqin, ose tek mua i kishte vajtur mendja. Se edhe grua-ja e ka keq, me të tiposur. Po iu mbush farza, o bën me ty, o bie e vdes. Nja pesë a gjashtë herë u mora me të.

— Po tjetra? — ngacmoi Rolandi.

— Me një grua në moshë, kur ruaja lopën. Asaj i kishte vdekur burri dhe me sa dukej digjej. Eh, ç'qenka njeriu. Më erdhi kur ruaja lopën. Më bënte shenja, shkelte syrin e me demek e ngrinte pak fundin e fustanit. Unë e nuhata. Kalova një mezhde dhe i vajta. Ishte një kanal pak më tutje. një si gropë me bar. E fshteta në ledh të gropës. Kisha takat më shumë atëherë, jo sa sot që rrezik të më merren mend. Kur po bëja atë punë e pyeta: «Edhe ti ke qejf?!» Do ti që ajo u idhnua, më shtrëngoi fort pas mezit e më tha: «Pse, çfarë jam unë që s'kam qejf?!» «Po je në moshë», i thashë. «Ta bëj qejfin aq sa ta bëj», ma ktheu. Ja kështu më tha. E Tasi s'të gënjen. Gjynah që njeriu rron pak. Eh! S'ka më keq se pa grua. Pesë vjet Tasi qyqar...

— Po të gjesh një grua sot, martohesh?!

— Posi...

— Sa vjeç të jetë gruaja?

— Edhe pesëdhjetë le të jetë. Mjafton që...

Plazhi ishte mbushur me çadrat e para. Ecnin. Deti e ndilte Rolandin të shkonte mes kripësisë dhe kaltërsisë së thellë. Tasi i hidhte hapat edhe më ngadalë. Femrat i përgjonte si gjithnjë.

— Unë gjer këtu vij, — tha i kënaqur Tasi sikur t'i kishte zbratur të gjitha.

— Pse? — pyeti Rolandi.

— Arrita te bunkeri. Atje fshtetem. Do të dukesh prapë?

— Do të të takoj, — ia ktheu Rolandi.

— Paç uratën... Eh sa pak rron njeriu, o djallë!...

## BAKUA

Në kasollë kisha mbetur vetëm. Edhe pak kohë dhe dielli perëndonte. Duhej të ishte java e parë a e dytë e majit. Jashtë vazhdonin të rënat e sopatës. Ndieja regëtimat që shoqëronin të goditurat. Pritej dru e rëndë. Ishte Bakua. Të gjithë kishin shkuar, veç nesh që e kishim shtëpinë larg dhe flinim në kasollet në pyll. Unë me shokët e mi i kishim në anë të lumit. Atë ditë, një shoku ynë, Lirimi, mori rrugën për në shtëpi, sepse kishte vajzën sëmurë. Edhe im atë, që vinte dhe më ndihmonte mua, atë mbasdite kishte shkuar. Dy net rresht e ngau një kollë e rëndë. Më erdhi keq. Flija më vonë se ai, se lexoja nën flakën e zjarrit, por kur dëgjoja të kolliturat e rënda, më dukej sikur babanë e zgjonte edhe oshëtima e lumit. Pastaj në krah të tij shtrihesha unë. Për disa minuta ndjeja dihatjet e tij lodhëse, të moshës apo të sëmundjes. Nën to i dorëzohesha gjumit pa u ndjerë. Pas mesnate përsëri zgjohej nga kolla e rëndë. Rrinte përgjysëm i shtrirë dhe mallkonte lodhjen e saj: «Hë, mos mbefësh, jooo!», — dhe sa bëhej gati të shtrihesha ajo e mundonte përsëri. Kështu vazhdonte disa herë. Në pamundësi ta zinte gjumi, ngrihej dhe i hidhte dru zjarrit. Ç'zjarr që bëhej! Pothuajse çdo natë do të mbetej ndezur...

Bakua erdhi dhe flaku sopatën mbi kasollen e mbuluar me katërma.



— Hë, more Xhelo! — më tha. — Brenda je?

— Po.

— Na e ndeze zjarrin, apo jo?!

S'e kisha mendjen fare tek ai dhe përgjigjen e vonova.

— Jo, o jo.

— Dil, more se do të piqesh nën katërma. Dil jashtë! — më thirri përsëri.

Brenda bënte shumë vapë, sidomos ditën, kur katërmaja e zezë i thithte gjithë rrezet e diellit e gati sa s'pëlcisje. Jashtë më ndryshe, pak më freskët. Lumi ishte kulluar i gjithë dhe shushurinte ëmbël. Më tej kasolles sonë ai merrte një kthesë dhe sikur fshihej nëpër rrapishte. Kur dilja jashtë dhe shihja këtë pamje, thujse shplodhesha. Rrapishtet mbanin mbi vete reflektet e fundit të diellit të asaj dite. Nga larg u dëgjuan zilet e mushkave të korçarëve. Bënin rrugën e fundit. E para ecte Ruska e Fidaiut dhe më pas të tjerat. Po i shikoja si zbrisnin. Një tufë zogjesh, nga ato që ne i quajmë gardelina, u trembën, ndoqën njëra-tjetrën dhe, çanë para nesh duke u fshehur pas rrapeve.

— Hë, ore! Shkulu! — thirri Bakua. — Hajde, babaxhan, lëviz të shpjemë hajvanët për ujë.

— Jam lodhur, — ia prita pa qejf e u nisa si i dremitur.

— Hë, kërcakës! Ç'e di drunë ti?! Të kënduar librash?! Do shpatull ajo, djalë...

Më dhimbnin krahët ditët e para aq sa edhe gjumi nuk më zinte, e nuk kthehesha dot kur flija, si të isha zënë ligsht. Lirimi, shoku nga fshati im, me një fytyrë të gjerë e hundë të madhe, faqe të hequra e flokë të shkurtër, qeshte me mua kur

më shihte se sa i avashëm isha në të ngarkuar. Shkretvoja së mallkuari hajvanin dhe qeshnin ndonjëherë kur në ato dreq brinja e ngarkoja gomarin me kokë lart dhe shkalla nuk më qëndronte fare. Më vonë ia mora dorën. Kështu më thoshte dhe Bakua me fytyrë eshtake, që nuk qeshte por më hidhte rromuze. Megjithatë me dukej i mirë. Kur ecte, lodhej shpesh, sepse dikur e kishte thyer një-rën këmbë dhe i dhimhte. Fliste pak dhe më tepër tregohej i heshtur se sa i gjallë. Kur shplodheshim, ai rrinte si mënjanë. Unë përzihesha me të shumtit dhe librin nuk e ndaja nga vetja. Bakua për këtë më hidhte ca sy të vakët dhe më tundte kokën.

— Lëre librin i biri Nazos! Ngit sëpatën dhe merri para ato frymë që harxhon. Edhe yt atë është munduar deri këtu. Ja, për këto para. E ti, më merresh me të kënduar...

Babanë e kisha marrë që të më largonte frikën mua, atë parandjenjë të punës së rëndë. Isha më i vogli mes drubarëve. Bakua s'para ma vinte veshin.

— Po Lirimi i Dudisë, ku është? — pyeti Bakua duke zgjidhur hajvanin.

— Kishte vajzën sëmurë.

— Hë, faqeshkari! Bëj kalamaj dëng e dëng dhe tani s'e mban vendi. Sa ka, se harrova?

— Shtatë vajza, ia kujtova unë.

— Yyy të kegen, jo. Një qerre me dhëndurrë. Bëj një djalë, more i uruar. Ai bëhet për shtëpi! — dhe filloi të vërshëllente avazin e hajvanëve për të pirë ujë. Pastaj mati perëndimin me sy.

— Iku koha, — më tha. — Duhet ndezur zjarri që të gatujmë ndonjë gjë për darkë.

U vërshëlleu edhe një herë hajvanëve, që i mbanin buzët nëpër ujë. Edhe korçarët poshtë nesh u jepnin ujë mushkave të tyre. Patkonjtë kërcisnin në zallishten e lumit e më pas kërcitja e tyre bashkohej me shushërimën e ëmbël të ujit.

— Hë, kaurët e dreqit, — tha Bakua. — Kanë hajvanë të mbajtur... Punojnë, qerratenjtë. T'u heqësh kapelen për këtë! Punojnë, — tha Bakua kur kishim arritur tek stiva e druve dhe lëshuar hajvanët për të rëmuar ndonjë gjëmbaç. Vetë po rregullonim drutë.

U err. Zjarrin e kishim ndezur dhe ishim ulur pranë tij. Pranë flakës lexoja Bërnsin skocez. Atje gjeja diçka nga jeta e njerëzve të mi fshatarë. Mendova t'i lexoja disa vargje me zë. A do t'i pëlqente Bakoja, që rrinte i heshtur e nën buzë sikur ia kishte marrë një kënge të vjetër, sikur këngëzonte mendimet...

— Shtyji urat dhe hidhi ca shkarpa zjarrit, — më urdhëroi qetë. — Duhet të marrë edhe pak valë tenxherja.

Bëra ashtu si më tha ai. Flaka u ngrit dhe unë kalova librin në faqen tjetër. Nga larg u dëgjuan të pëllitura hajvanësh, të çjerra, shqelma dhe rrëzimi i një stive drush. Bakua, si më i vjetër, e kuptoi shpejt se ç'kishte ngjarë.

— Ah, murrua i Lirimit, po kafshon gomaren tënde. Hidhu një hap dhe ndaji shpejt!

Lashë librin hapur dhe u nisa me vrap. Nga pas dëgjoja se ai ende më fliste.

— Shite, more Xhelo! Shite, ore të uruarën! Një gomare këtu na harboi gomerët. Na i lë mëndjengritur, pa punë e pa ngrënë...

Fjalët e tij nuk i dëgjova më. Isha larguar duke

kërkuar gomarët në stivat e druve, që vazhdonin t'i rrëzonin. I kapa dhe i lidha larg njëri-tjetrit. Grazhdet ishin bosh dhe u hodha nga një dorë bar. Më shumë lakmova tek hajvani i Lirimit.

Kur u ktheva tek zjarri në kasolle, librin nuk e gjeta në vendin që e lashë. Ishte mbyllur dhe hedhur mbi pallton time pa kujdes. Një shkëndijë zjarri ishte fikur mbi të e një anë kapaku ishte përthyer. Vëreja me sy Bakon që nuk po e prishte terezinë. S'fola. U ula dhe shfletova librin atje ku e kisha lënë. Atë faqe nuk po e gjeja. E afrova pranë flakës dhe shtanga. Ajo ishte grisur. Kishte mbetur një shenjë, që të linte të kuptohje se ishte këputur nxitimthi. U mbusha me inat, si të më kishte pickuar një grerëz. Shikoja flakën, prushin e zjarrit mos dalloja ndonjë shenjë flete të djegur prej tij. Shkarpat e thata prej çëmërdele kërcisnin. Ai largonte ndonjë shkëndijë fare i qetë sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Bako! — fola ngadalë sikur desha ta merrja me të mirë. — Përse e ke grisur këtë faqen e librit?

S'më ktheu përgjigje menjëherë. Afroi dy ura të mëdha e foli qetë-qetë:

— Dësh na u derdh gjella. Kapa tenxheren mos të më digjte. Ja fleta, atje tej është. Po të duhet, merre!

— Është libër. S'ke të drejtë të ma grisësh. Ata janë si...

— Lëre për kokën tënde, lëre se si janë... — u mbush me frymë sikur do të më bindte me fjalët e tjera. — Për pak mbetëm pa darkë, — dhe hodhi sytë mbi tenxheren e gjellës.

Në të vërtetë oreksi më iku. U ngrita dhe kër-

koja nëpër terrin e natës fletën e grisur. E gjeta. E bërë shuk ishte nxirë. Ç'njeri? — thashë me vete. Po a grisen librat?! «Njeriu me kulturë nuk i gris kurrë», — më thoshte mësuesi im dikur. Po donte t'ia dinte Bakua për kulturë libri?! Si të flisja me të?! Pak e njihja.

— Di të lexosh?! — pyeta me pak zë dhe u ula në vendin e mëparshëm.

— Di, por nuk më këndohet. Boll të këndoju një letër e të shkrap një firmë, të marr paratë, — dhe u ngrit e hyri në kasolle.

Nata ishte e freskët, Lumi ëmbëlsonte yjet e qiellit. Larg, nga e djathta jonë, ura me pasarela po jepte disa kuitje çjerrëse. Dikush kalonte. Nga ana tjetër e lumit lehën qentë e një tufe dhish, që i pushoi vërshëllima e bariut. Bakua doli nga kasollja me dy copa buke në dorë dhe dy lugë. Shtroi mbi tokë një copë palstmasi të bardhë dhe të pastër. Pranë afroi tenxheren. Nga xhepi nxori një kokërr qepe të madhe, e vuri mbi një gurë që ishte në anë të zjarrit dhe i ra përsipër me pëllëmbën plot kallo. U ndje era e saj. Hodhi një copë drejt meje.

— Haje se të bën mirë për sytë, sidomos ty që merresh me të kënduar librash, — tha Bakua me një buzagaz të vogël, që më ngacmoi.

Ajo ra mbi plastmasin e bardhë. Fillova të përtyp një kafshatë, po s'më shtyhej fare. Nuk më ikte zemrimi për fletën e grisur. Ai përtypej me uri. Gjithë ditën kishte ngarë sopatën.

— S'të paska marrë uria, sot?! Mbushi ore zorret! — dhe ktheu një rriskë buke që e kishte lënë për të thekë. — Ka lezet kur të ngroh pak bar-kun kjo virane, — foli si me vete. — Edhe ti, hi-

dhi barkut. Do shpatull sëpata, jo gëc mëc. Dëgjon!

Dëgjoja. Ndiqja përtypjet e tij e vetë përtypja inatin. Sa të filloja për të ngrënë ai foli përsëri.

— Kaq shumë qënke prerë për atë copë fletë?! Fletë letre është, të shkretën. Nuk u bë...

— Më vjen inat, — i thashë. — Kemi gjashtë muaj bashkë dhe librat e mi asnjëherë nuk i ke dashur.

Shkarpat vazhdonin të kërcisnin më të rrallë. Degët e rrapeve filluan të lëkundeshin. Një erë e lehtë po na rrihte shpatullat: Qielli i pastër, i mbushur plot me yje, sikur ndiqte nga afër bisedën tonë.

— Nga librat, për vete, nuk kam parë hair, — tha duke u përtypur. — Më ka ushqyer krahu. Asnjëherë nuk sosem së kënduari një faqe.

— Po fëmijët, si i ndihmon për të lexuar? A ke dëshirë të dëgjosh fëmijët e tu kur të lexojnë bukur? Po kur shkruajnë?!... Sa fëmijë ke në shkollë ti, Bako?

— Fëmijë?! Unë fëmijë?! — dhe i mbeti luga në dorë. Dora iu drodh pak dhe gjella iu derdh. Kapërxeu atë kafshatë që kishte në gojë thatë, tundi kokën shumë lehtë dhe ngadalë mbushi lugën me gjellë. S'hante më shpejt. Në të vërtetë nuk e dija se sa fëmijë kishte. Më thoshte mendja më shumë se tre. Dhe të parin patjetër në shkollë. Mendoja kështu, se Bakua ishte aty te të dyzetat. Nja shtatë vjet ishte Lirimi më i madh dhe kishte shtatë vajza njëra pas tjetrës. Fliste shpesh për vajzat e tij dhe dy të parat i kishte në shkollë. I mësonin dhe kënaqej. Në pyll na fliste për të gjitha ato. Unë bëra dhe një shkrim të vogël në gazetën lokale duke

folur për të si prind i mirë. U gëzua aq shumë sa edhe gazetën e mbante në xhep.

Bakua vazhdonte të hante ngadalë dhe kushe-di ku e shpinte mendjen. Ndoshta te puna që do të bëjmë, apo tek fshati i tij, që unë nuk e kisha parë asnjëherë. Ai fshatin e donte. Këtë ma shtinte në vesh jo rrallë gjatë mbrëmjes. Vetëm për gruan e tij, fëmijët, nuk dija asgjë, sepse s'më pat folur kurrë. Çudi?! Asnjë rast. Kurse unë e fytyroja Bakon kur shkonte në shtëpinë e tij, pa hyrë në deriçkën e fundit të oborrit i thërriste ndonjë fëmije, vajzë apo djalë, si për të lajmëruar ardhjen e tij të shumëpritur. Ata do të rendnin me hapa të vogla dhe krahët e vegjël që i lëkundin me disa lëvizje thujse harmonike. Ai patjetër do të qeshte. Malli i fëmijës. Pastaj me krahët e mëdhenj do t'i përfshinte në kraharorin e tij ose do t'i hipte rmbi samar të kafshës...

Por e gjitha kjo ishte fantazia ime. Tanimë nuk doja të fantazoj. Më hypi në kokë, ndoshta nga inati i fletës së grisur, dhe e pyeta me ton të ashpër:

— Bako! Sa fëmijë ke?!

Ndërkaq vazhdova ta pyesja: A të shplodhin kur shkon në shtëpi?! A t'i tregojnë fletoret e tyre me notat që marrin? Apo të dalin përpara duke thirrur erdhi babi im? Kur je larg, fëmija nuk ta shpreh dot mallin, veçse kur të shikon, ta dish se rend me lot në sy. Me mallëngjimin e zgjuar në çast nga prania tënde, i gufon kraharori i vogël. E ti nuk di kë të shikosh më parë: syrin e vogël, që ndrit, apo krahët me doçkat topolake që i tund pa pushim?

Bakua s'po hante më dhe nofullat e tij bluanin

kot në gojë. Gjella lëshonte një avull të ngrohtë dhe të pakët. Luga e vendosur në anë të tenxheres i ra në shpuzë të nxehtë duke e përlyer. E mori dhe e fshiu pas pantallonave e mbi llërën e krahut. Qepa po fishkej pranë zjarrit.

— Në libra i ke kënduar këto? — pyeti duke thyer heshtjen disi të gjatë, që e ndante midis nesh vetëm zjarri i ndezur.

— Po, — i thashë. Ato më kanë mësuar shumë gjëra. Më tepër se sa të thashë ty, por ti nuk më ke afruar asnjëherë.

— Po, njerëz, si unë, a kanë ata librat tënd? — pyeti prapë Bakua.

— Edhe kanë. Patjetër që në libra ka edhe njerëz si ti. Se është e madhe bota e librave, Bakoo, — sqarova unë si të isha profesor. S'foli. Tani ishte ai që shihte yjet e qiellit. U ngrit dhe hodhi pallton krahëve. Filloi të thyente shkarpa për zjarrin. I thyente si pavetëdije.

— Më ke thënë se drutë i thyen zjarri. Mos u lodh, — i thashë unë me pak zë.

Flaka u rrit dhe unë dallova më mirë fytyrën e tij, që mbante një çehre tjetër.

— Dëgjo, i biri Nazos! Unë nuk kam fëmijë! M'u duk se iu deformua fytyra dhe sytë iu zmadhuan. Pastaj foli me një ton disi të hidhur:

— Jam vetëm. Nuk më kanë martuar. Jo...

Zjarri sikur më dogji dhe u largova pak. Nuk e mora dot me mend se ç'formë morën fjalët e tij, veçse ato u hapën e sikur ranë për rroth të rënda e të dhimbshme. Bakua i palodhur, që aq shumë e donte punën dhe besonte tek ajo thjesht pa hyrë në të thella e zhbirime të lodhshme. Veçse ajo i



sillte kënaqësi duke mos e ditur se sa orë në ditë punonte.

Ai pra s'kishte fëmijë dhe unë nuk e dija. Më erdhi keq. Me se e mbushte ky njeri këtë boshllëk të madh?

— Bako! — e thirra lehtë duke shtyrë urat e zjarrit që të dalloja më mirë tiparet e fytyrës së tij disi të mbledhur e me pak rrudha. — A s'më thua, përse nuk të kanë martuar? Nuk u gjend një copë nuse për ty? Të gjithë...

Heshta. Më mungonte fjala që duhej të zgjidhja. Libri im mbeti prapa.

— S'më kanë quajtur të saktë kurrë. Baba-xhan, nga ai dynjallëk s'marr vesh. E troç. Me demek më thonë se jam gjysëm njeri, — më marrshin ato të gomarit!... Taramam! Më marrshin të keqen, se puna nuk më është mërzhitur kurrë. E po bëj nga dy norma në ditët. Më thonë se nuk kam në terezi gurët e çakmakut, — tregoi kokën me dorë, — po unë nuk zihem. Deshi qejfi njerëzve dhe më bien në qafë, pse m'i lëvizin gurët?!...

E shikoja Bakon dhe ndoshta tani po e njihja. Hej, dreq, o Bako! Si nuk e dija se ti qenke njeri pa njeri?! Kaq kohë dhe ti nuk na the?! Kështu paske qenë ti, Bakua im. Pa fëmijë. Tani po e kuptoja ftohtësinë ndaj fëmijëve të Lirimit, sepse ai nuk ishte bërë asnjëherë baba.

— Bako! — i fola me kujdes. — I ke humbur shpresat se një ditë mund të bëhesh baba?!

— Ëë! Nana?! Eh, o Xhelo vëllai!...

— Po, baba!

— Po kush u martua e s'u gëzua... Mua...  
— dhe ngriti supet si fatkeq. — Mbeta vetëm baba, për punën, o Xhelo.

— Të lexoj diçka nga ky libër, Bako! — fola përsëri duke e quajtur veten fajtor para tij.

— Dashuriçka djemurie?! Kot. Në atë defter s'jam, — thuajse e ndryshoi zërin ai.

— Jo, jo. Librat flasin edhe për njerëz si ty.

— Si mua?!

— Po.

— Eh, more. Kush pyet për ne. Sa e ngasin parmendën e sopatën si puna jonë... E çfarë?! Për budallenj të na fusin në ato faqe? Kartat i mbushin njerëzit e mençur. Ne...

— I mençur është ai që derdh djersë, prodhon diçka të mirë. Edhe ti...

Më vinte inat të pëlçisja, por nuk zbrasesha dot. Bakoja filloi të më dhimbsej dhe po të harroja atë çast fuqinë e tij të madhe në punë do të më dukej njeriu më fatkeq.

Heshtjen e çau vetë. Si padashur erdhi pranë meje dhe vendosi dorën shputë (në çast s'm'u duk e tillë) mbi pëllëmbët e mia me kallo të njoma e dy-tre gishtrinj të fashuar. Ai i kishte më të vrarë se mua, pa lidhur. I ishin ashpërsuar dhe i dukeshin gjithë brazda. Më preku librin. E afroi pranë zjarrit sikur donte ta ngrohte. Shfletoi faqet si për t'u hyrë ngrohtësia brenda. E ndali atje ku e grisi. Fshiu njëherë duart pas pantallonave e pastaj i ngjeshi mbi fletë. U kthye nga unë me fytyrë lutëse por të ndezur.

— Të lodhin librat si sopata?

Ngrita supet dhe me një buzëqeshje i thashë:

— Edhe të lodhin. Shpesh herë këta presin më shumë se sopatat tona. Dhe kur presin këta e kanë sopatë të rëndë, o Bako.

— Ashtu? Ma lexo këtë! — u lut si fëmijë.  
— Edhe vet e nxjerr ngadalë, por e dua nga ti. Të ma lexosh mirë!

Qeshi vet me ëmbëlsinë e fytyrës dhe priti ligjërimin tim. Ia nisa me një vrull ritmik. I dija përmendësh ato vargje dhe sytë në libër nuk i hidhja fare. Shihja Bakon, atë që s'e pata njohur. Ai nuk i hiqte sytë nga libri, si të më ndiqte mua për gabime drejtshkrimore. Ai, kockëforti e duarashpëri... Mbarova së lexuari.

— Bako! Do të bëj një shkrim në gazetë, ashtu si Lirimit.

— Po unë s'kam fëmijë, — foli si i zënë në faj. — Lëre atë punë. Hë! Vazhdo më tej!

— Ke krahë të fortë ti, Bako. Derdh gjithë atë djersë me nder. Merr gjithmonë atë që të japin.

— Hë?! Mbaroi libri?! Nuk ka më?!

Tunda vetëm kokën.

— Po gjithë këto faqe të tjera?! Nisja një tjetër, — më nxiti. — Ja, unë po bëj zjarr, po hedh shkarpa që ti të kesh flakë më shumë! Hë, Xhelo vëllai! Jëpi!

Flaka rritej dhe ai largonte gjumin. Lumi shushurinte gjithmonë ëmbël sikur donte të vinte me këngën e tij pyllin e madh në gjumin e natës së freskët plot yje. Ja, midis tyre ndodheshim ne. Aty te ai zjarr, jashtë kasolles sonë me kalërma, ku unë fillova të ndieja një këngë tjetër. Atë që filloi ta ndiente Bakoja. Lexoja dhe mendjen e kisha te krahët e tij që për njëzet vjet ngisnin sopatën pyjeve.

## RAKIA DILTE E MIRË

Plaka Sano, e gjatë, fytyrë thatë, por e mbajtur, fshiu buzët sepse i kishin mbetur shenja kafeje. I lëpiu dy-tri herë dhe përsipër i shkoi cepin e mësallës paksa të vjetër. I ishin bërë atë ditë pesë kafe, po edhe dy-tri të tjera të pinte nuk mërzitej. E bridhte lagjen e vjetër plaka Sano derë më derë. Jo vetëm lagjen e saj, por edhe lagjen tjetër që gjendej më sipër, sepse edhe andej kishte grari e plaka si ajo. Edhe andej kishte muhabetë që i kënaqej veshi e ngryste ditët me radhë. Pesë shtëpi kishte shkelur atë ditë. Tek çdo njëra thosh: «Mos, moj hankoçe! Mos të keqen se s'kam ardhur për kafe unë. Edhe s'gjendet e uruara. Ajo një pako rracion e muajit s'ka dukë: Për vete a për miqtë. Lëre xhezven, hë për kokë tënde. Ja erdha të këmbejmë ndonjë fjalë me njëri-tjetrin. Ee, shyqyr që jemi mirë. Në dasmën e të pamartuarëve!...» E zonja e shtëpisë begenisej për kafën dhe plaka Sano, pasi ia ndiente erën, fillonte muhabetet e reja radhë. «Nusja e Arshinit zihet me vjehrrën. Qenka një grindavece ajo nusja, moj të keqen, që s'paska shoqen! Po kush ia bëri, moj, kush ia bëri nusen Arshinit? E?! Aaaa! E ka gjetur vetë. Ah, mortja këta djem! Shih femra e zgjat dorë.. U janë zënë sytë xhânëm? E shkreta Çarçike! I zuri derën! Xhemilja e ndau nusen e djalit së bashku me të birin e i dha vetëm një ko-

nak. Aman se kjo Xhemilja është grua e keqe! Ta shkosh në hell është. Nuk ndahet nusja kaq shpejt! Mësoje, moj të keqen! Mësoje të të ngjajë dhe... Po nga ajo derë që ka dalë Xhemilja, moj hankoçe, është të zësh kokën me dorë. Soj i keq. Soj jeziti. Ylvijes! Dëgjove, moj të keqen?! Ylvijes ia prishën llafin e djalit që kishte në Brozdovec të Korçës. E po i mbetën djemtë të pamartuar të shkretës! È?! E ç'është kështu, moj të keqen? È?! Po edhe gjer në Brozdovec është larg?! Më mirë që nuk i bëhet...»

Dhe Sanua rrëfente e rrëfente... Hynin e dilnin historitë e saj. Mbilleshin rrugëve të lagjes, hynin nga dritaret e mes oborrëve, ngjiteshin me zhurmë në lagjen mbi të dhe të tjera zbrisnin që lart më me berihaj. S'numëroheshin kafetë e Sanos.

Pas kafesë së pestë, kur fshiu buzët me cepin e mësallës, ndaloi. hapat midis rrugicës që ndante shtëpitë e Hajros dhe të Abdullait. Shamitë e kokës (ajo mbante tre shami të lidhura njëra mbi tjetrën) i kishin shkarë paksa mbrapa dhe i zbuloheshin flokët e kuqërremtë, të rralluar, që pas koke i bënte gërsheta të vogla dhe i lidhte me një copë llastik të vjetër. Nuk e ndërronte atë copë llastik sepse e kishte hapur nëpër graritë e lagjes që ia kishte lënë vjehrra, zonja Konxhe, kujtim, si mall i ardhur prej Turqie që në kohë që s'mbahen mend. Llastikut s'mund t'i thoshte më llastik sepse ai kishte mbarur me kohë e nuk shtrihaj fare, por Sanua i bënte qejfin vetes dhe sa herë e mbante një shami zgjidhur që ta rregullonte atje ku do të pinte kafënë. Mes rrugës, e ndalur, i ra erë bërsi rrushi. Ndolli pak, si plakë e kujdesshme,

hundët dhe diç murmuriti në heshtje. Do të shkelte edhe në katër shtëpi të tjera dhe ishte e sigurtë se pa kafe nuk do ta përcillnin. Atje do të dëgjonte se ç'kishte bërë hanko Dudia me çupën që shkoi në Lushnjë. A e bitisi fejesën, se edhe llafet në mëhallë janë hapur. S'ishte e paktë për Farijen që do t'i shkonte më pas për t'i treguar ato më të fundit. Bashkë zbërtheheshin si në ujë valë. Nusia e Farijes bënte dy kafe që më mirë të mos i pije. Një për Sanon e tjetrën për Farijen. I linte të dyja gratë plaka të rrëfeshin si matufe mbi filxhanët dhe kalonte vetë në dhomën tjetër duke përplasur derën. E pati bërë disa herë këtë zanat dhe hankoja, Farija, mbliidhte buzët, tundte kokën dhe kur mbyllej dera, shante me gjysëm zëri aq sa dëgjonte Sanua. «Mortja, mortja nusen! Grabë e keqe!» Pastaj i qahej Sanos. Sanua nga ana e saj i kish thënë që me të dëgjuar e kishte se mbesa e Farijes, çupa e Grabës së keqe, paskësh flakur dobiçin në mantertinetin e qytetit dhe asaj nuk i kishin treguar. Plaka Farije bëhej tym. Thërriste nusen për kafe tjetër dhe shtërngonte ballin rreth kokës me një çember të bardhë. E muhabeti ndizej, dera përplasej, Graba e keqe thërriste aq shumë që Sanua të ngrihej për të dalë. Dhe ashtu kishte bërë, por Farija e ulte dhe me zor e mbante që të rrëfehej e tëra. Qëndronte Sanua, se ashtu e kishte, me pak të lutura. Kthehej mbesa e Farijes nga shkolla e mesme, i puthte të dyja plakat, qeshte, ndërsa ato vidheshin në sytë e njëra-tjetrës si të bënin e prishnin magjira. Farija e shikonte nga sytë se a ishin të ndritshëm, ndërsa Sanua nga kofshët, vithet, gjoksi, barku e më poshtë tij, si të

dallonte gjurmë të dobiçit të flakur. Mbesa djallëzore buzëqeshte kur plakat i shikonin konturet e trupit dhe i puthte sërish ato. Plakat tundnin kokat, fshihnin faqet e puthura si me inat, përmbysnin filxhanët dhe fillonin prapë muhabetet...

Sanua, e ndalur mes rrugës, vendosi të kthehej një copë herë nga kazani i Hajros, andej nga vinte era e bërsivë të rrushit. Atë plak, që ajo e quante matuf, i dukej se e shoqja, vërsnike e Sanos (Sanos i kishte vdekur burri) e hiqte për hundë e ziheshin shpesh të dy. Sanua u fliste e u thoshte ndonjë fjalë, por nga ana tjetër mermëriste: «Kokën hëngërshi! Do të merrem me ju!» Hajrua s'ia vërshej shumë Sanos. Kur vinte ajo, nga herë e gjente shtrirë në kuzhinën e vogël, të mbuluar edhe kokën me pallto. Një ditë i kishte thënë: «Mbetë, o Hajro, gjithë ditën bythën kobure. Lëviz një çikë!» Hajrua mermëriste pa zbuluar kokën dhe kthehej në anën tjetër duke gërhitur e nënqeshur për Sanon, që s'linte derë pa bredhur...

Plaka Sano shtyu derën e vjetër të katoit, ku nxirrej rakia dhe zgjati kokën brenda. Ishte errësirë, dhe drita e paktë nuk e ndihmonte të shihet se çfarë bëhej brenda. Hapi edhe pak derën që bëri zhurmë. Hajrua s'lëvizi. Ajo hyri brenda.

— Hë, zoti Hajro! — foli me pak zë.

— E?! — mermëristi me kokë mbuluar se e dinte që kazanin e kishte terezi.

— Prapë bythën kobure?!

— E po timen e kam, — foli si pa qejf Hajro — E, me që e kam timen e ngre si të dua.

Sanua qëndroi para çurkut të llullasë, ku një pe i hollë rakie mbushte tenxheren dhe rruazat e shumta që notonin tregonin gradacionin e mirë,

ndërsa bërsitë qëndronin brenda një kadeje të madhe dëllinje gjysmë të përmbysur.

Hajrua largoi flakët nga kazani i madh.

— U lodhe zotrote? — pyeti Sanua.

— E po, helbette...

— A del ndonjë çikë?

— Mirë është, mirë, jo keq...

Ai tundi një shishe arançate, e cila shkumbëzoi e gjithë.

— Keni rrush ju zotrote dhe...

— Ishin kalbësira sivjet, Sano...

— Po kalbesh ti që punon, e jo pjergullat që u dergjën mot e jetë në një vend, — i tha Sanua dhe u ul mbi një kërçep lisi, pranë enës ku mbli-dhej rakia e ngrohtë.

— Nuk të kam parë, — i tha Hajrua me ironi Sanos, e cila e tallte gjithmonë duke i kujtuar vdekjen. — S'ke dalë fare.

Sanos i erdhi inat që ai plak matuf kërkonte të tallej dhe si e paduruar u ngrit në këmbë. Era e rakisë të tërbonte fyejt e hundës.

— Isha nga çupat në Lushnje.

— Ç'thoshnin ata njerëz andej?! Mirë ishin?!

— pyeti seriozisht Hajrua. — Ç'bënte ai kallaballëk?!

— Mirë, mirë! — u përgjigj Sanua pa i rënë inati ndaj këtij plaku matuf, që u afrua te çurku i rakisë, në grykë të llullasë. Mbushi një gotë dhe e hodhi në anë të kazanit a do të digjej. Flaka jeshile u shua shpejt.

— Hëëë! Pooo! Mirë, mirë vazhdoka! — dhe e vendosi gotën mbi gur.

— Po mbahesh zotrote?! — pyeti Sanua me duar mbledhur e lidhur nën mësallën e zezë.



— Bereqarves, bereqarves! — u përgjigj Hajrua dhe trazoi prushin nën kazan.

Sanua fshiu buzët dhe uli duart përsëri nën mësallë.

— Do të ulesh? — pyeti Hajrua.

— Të ulem?!

— E, provoje njëherë rakinë.

— Jo, jo. Nuk ma qas gjëkund.

— Si të duash. Kafeja të pëlqen zotrote.

— S'kam pirë, o i zi, jo.

Hajrua dalloi në anë të buzëve të saj pak shenja kafeje pa fshirë. Nuk i tha gjë.

— Po mirë ishin andej?!

— Mirë, mirë! Të fala ke nga Laver beu.

Hajrua trazoi një urë zjarri.

— Nga kush?

— Nga Laver beu, shumë të fala.

Urën e zjarrit e zhyti mes prushit dhe ajo u ndez.

— Laver beu, the?!

— E...

Ai ngriti kokën e ktheu një gllënjë rakinë. Iu drodh një damarë dhe i mbërtheu sytë Sanos, e cila u hutua nga ai vështrim.

— Me një fjalë, të dërgoi të falura për mua?

— F. e...

Hajros i erdhi një lëmsh në grykë dhe rakia e porsa kthyer iu bë helm. Shtërngoi shishen në dorë dhe picërroi sytë.

— Hanko Sano, hanko Sano! Si ma ke atë ndërshalë?! È?!

Zërin nga fundi e ngriti dhe përplasi shishen fort në truall.

— Si?! — habiti Sanua.

— Atë ndër shalë, zotrote, si ma ke?! — nuk i ra inati aspak Hajros dhe shtërngoi dhëmbët.

— Pse më pyet kështu, Hajro be?!

— Përse, më thua?! — nuk e uli zërin Hajrua.

— Pse moj shushkamane nga të vdekurit më sjell të falura ti mua?!

Ajo ngriu e habitur.

— Harrova, Hajro be, harrova. M'u thaftë goja ç'bëra! M'u thaftë! Ja kështu! Desha të thosha se ke të fala prej Myslim beut. Ja këtë desha të thosha.

— E, e, po paske lajthitur, Sano. Vate puna tënde me të shumtit.

— Jo, ore korb, jo. Ti u matufepse e çoç të lëshoi goja ca fjalë.

— U matufepsa, ë?! E pse? Pse të pyeta ty për atë ndërshalë?! — dhe i preku me dorë fundin e fustanit të zi duke ia ngritur pak lart.

— Hë! Tartakut! Jezit! Hiqe dorën se je plak e nuk të ka lezet të ngresh fustan' e plakave.

— Nuk të ngas, moj murdallëke, jo, por thirrri mendjes. Mos më sill të falura nga të vdekurit. Ata lëri me të vdekurit e mua të rroj me të gjallët.

— E mirë, de, mirë.

— Dhe... Mos lëviz shumë nëpër lagje se do të hyjë ndonjë hu.

— Ke kthyer ndonjë gotë kështu, që folke si bilbil sot, Hajroo! — i vinte inat Sanos.

— Po te kazani jam. Ti s'deshe, shko andej nga ajo zonja ime dhe pi ndonjë kafe.

— S'më pihet.

— Lëri, moj huqet dhe nisu!

— Ah, more mavri, ah! Ta ka mbledhur jot shoqe!

Hajrua ktheu edhe një gllënjke tjetër si i ardhur në qejf.

— Eee! Ashtu ia përmbledhim njëri-tjetrit, — u krenua Hajrua. — Po ti ke vite që u dogje...

Sanos se si i erdhi mirë që Hajrua e ngacmonte me ato fjalë dhe tani s'po i dukeshin aspak të matufepsura sytë e Hajros. Iu rrëngjeth trupi i hollë dhe i mbajtur. Si në një hark elektrik iu kujtuan vitet e nusërisë së dikurshme që të merrte më qafë nga bukuria.

— Hë! S'të iket?! — e cyti Hajrua.

— Poo, ja, po nisem të pyes njëherë si kalojnë andej e a mbahen...

— E e e! Mbahen, mbahen, po shko e gjerbit një kafe të zezë.

Ajo hyri në shtëpinë e Hajros pa trokitur ashtu si bënte gjithnjë. E shoqja e Hajros e priti me një breshëri fjalësh, përse s'kishte dalë e kishte humbur kaq gjatë.

— Të të bëj një kafe?!

— Nuk më pihet! Edhe ajo e shkretë është me të keq, me rracion.

— Do ta pimë nga një, — tha e shoqja e Hajros dhe vendosi xhezven në zjarr.

— Hajrua nxirrte rakinë, — tha për të hapur muhabet.

— E. Nxjerr. Ka tre ditë ngritur kazan.

— Rakia dilte e mirë!

— Nuk kam nge të vdes e jo të shikoj rakinë, — ia ktheu e shoqja e Hajros duke bërë kafënë.

— E pashë unë, e provova, — gënjeu Sanoja. — Dilte e mirë. Hajro beu ia ka marrë dorën. Ke goxha plak zotrote, — përfundoi Sanoja e lumtur

që kafja e zezë po hidhej në filxhan dhe që Hajrua nuk ishte aq matuf sa mendonte.

**Nëntor, 1991**

## NESËR, NË DRITËN E DIELLIT

Për t'u shplodhur pak i hyj baçes në shtëpi mes për mes. Kjo thujse është një shëtitje e vogël e mbrëmjes sime. Pemët e zhveshura me lastar të ngritura më ngjajnë si fatkeqe mes asaj ere që i lëkund e i rreh si me rrënoqethje. Im atë ka punuar gjysmën e baçes, pjesa tjetër e papunuar mbulohet me gjethe të rrëzuara, në një ngjyrë kafe të humbur. Nga era që fryn ndiej pak të ftohtë. Diku pas gardhit të vjetër të kopshtit shikoj shenja pranvere, lule nga ato të hershmet. Pas shpatullave të mia një pjergull e hazdisur ka rënë në tokë. Im atë, kujdestar i madh për to, ndoshta nuk e ka parë. Lë gjithçka pas shpine, nën fatin e mbrëmjes muzgëndjellëse dhe hyj në shtëpi. Të gjithë rrinë ulur e flasin thujse fare pak. Mbesa luan me çantën time të zezë dhe i derdh gjithë librat e fletoret mbi dyshtemenë me dërrasa. Vëllai i vogël (i vogël i them unë se ai sapo është kthyer nga shërbimi ushtarak) i bërtet.

— Flora! Mos po të them! Mos e prek çantën e xhaxhit, se do të rrah.

Mbesa për drej ka mësuar një huq jo të mirë, që i nxjerr pak gjuhën dhe mua më duket sikur i thotë: «S'ke çfarë më bën!» Për fat ajo nuk bën ashtu, por flet ngadalë me zërin përkëdhelës të një fëmije të zgjuar.

— Edhe unë do të bëhem mësues, si xhaxhi, — thotë ajo, dhe padashur gris një fletë të bardhë ku nuk është shkruar asgjë. I nxehur vëllai i shkëlqon pak veshin.

Mbesa skuqet në fytyrë dhe gati shpërthen në lotë.

— Mos i fol, — i them vëllait të vogël. — Nuk gris asgjë, — dhe e marr mbesën me të mirë, e cila qetësohet menjëherë. Pas pak, nga fletët e një libri mbesa, që s'i rrinë duart asnjë çast, nxjerr një fotografi.

— U u u, xhaxhi në fotografi, — thotë ajo dhe duke qeshur zbulon dhëmbët e vegjël të rreshtuar si kokrra shege, veçse me ngjyrë të bardhë. Pastaj sytë i qeshin më tepër e mua më duken si sytha të vegjël pranveror në ditën e parë të shpërthimit të tyre.

— Xha-xha-xhi, kjo teta kush është?

Në fotografi është një shoqja ime mësuese, një vajzë qyteti. Sa përgatitem t'i përgjigjem mbesës së vogël ajo më pyet përsëri:

— Xhaxhi! Nuse është kjo! Nusja tënde?!

— Po unë nuk kam nuse, moj motër, — i përgjigjem me zërin qetësues. Kjo është një shoqja ime mësuese ashtu si unë. Mbesa e shikon prapë si me dyshim fëmije.

— Xhaxhi! Ta puth pak? Vetëm pak!

— Puthë.

Pas puthjes së mbesës, fotografia ku ndodhem unë kalon dorë më dorë. Në të shikojnë një vajzë qyteti. E shikojnë të gjithë, veç nënës. Ne jemi shumë vëllezër dhe që të gjithë banojmë në fshat. Vëllai i madh, që ka dy vajza, e sheh me kujdes e më shkel syrin sikur do të më thotë: «Hë, qe-

rrata, qerrata! Ke gjë me këtë? Qenka alamet vajze!» Pastaj e merr vëllai tjetër. Ai e vështron si një mbikqyrës i zoti.

— Kjo është ajo vajza nga qyteti? — pyet ai.

— Po, — i flas unë. — Para një jave erdhi tek ne fotografi dhe...

— U paska nxjerrë mirë, — thotë ai. — Edhe si vajzë më duket e mirë, e thjeshtë.

Pastaj e morën të tjerët. Kur e merr vëllai i vogël fillon nga rromuzet.

— Ë ë ë... — ia bën ai dhe tund kokën. — I paske hedhur grepat. Mirë paske kapur. Ngjalë për zotën. Po të kam thënë unë, vëlla. Ti rrallë i hedh grepat, por di të peshkosh mirë ama, — dhe i ul sytë mbi të sikur kërkon të përcaktojë gjëra të tjera të hollësishme.

Landa, ajo që ndodhet në fotografi, ka disa tipare tërheqëse sidomos nga fytyra. Mban ca flokë të shkurtër, sy gështenjë dhe të ndritshëm; faqe të kuqe, që shpesh herë i purpurohen si mollë e pjekur; gojë të vogël dhe mjekrrën të ngritur pak lart. Duket tepër e singertë. (Në të vërtetë kështu e njoh). Dolëm në fotografi duke pasur si urë bashkimi miqësinë tonë dhe kështu kisha nisur ta respektoja gjithmonë. Çiltërsinë time ajo e vlerëson dhe më tregon shumë biseda që nuk ia them askujt. Nuk di të mburret. Edhe në shtëpi i kam shkuar disa herë, aq sa të njihesha edhe me njerëzit e saj. Më vonë Landa më tregoi se donte një djalë nga një qytet i Myzezesë, që ishte sportist. Kur ai u shkëput prej saj, duke mos i dalë në telefon, dhe më vonë i ndërpreu letrat, ajo u mërziu jashtë mase. Sportisti pretendonte të luante me një nga skuadrat e kategorisë së parë dhe nuk

mund të donte vajzën e një qyteti provincial mes  
malesh. Landa hynte në sallën e mësuesve e hesh-  
tur. Rrinte pranë zjarrit dhe ndiente dimër. Ze-  
mra e saj ishte e plagosur dhe sytë ndonjëherë i  
ruanin një shkëlqim të ngrohtë loti. Edhe mund t'i  
shpërthenin po ta prekja sado pak në ndjenja. Më  
dhimbset kjo vajzë dhe djalin që e gënjeu fillova  
ta urrej, megjithëse nuk e kisha parë kurrë. Landa  
kërkon vetmi. Unë, kur jam vetëm me të, i jap  
zemër se është ende njëzet vjeçare e se ka moshë  
për dashuri. «Mos u bëj budallaqe, i them shpesh.  
Harroje atë djalë, ashtu si të harroi ai.» I flas gjatë  
dhe ngrohtë, thjeshtë e çiltër, aq sa di të flas unë një  
djalë fshatari për dashuri të virgjër, aq sa mund  
të kuptoj unë për pastërtinë e saj, si pastërtia e  
lëndinave plot lule të fshatit tim...

Ajo edhe qetësohet ndonjëherë. Qesh me ne.  
Qesh si të kujtojë se e ka shpirtin pranverë, të pa-  
stër e pa asnjë plagë, me blerim të brishtë e jetë  
të panisur. Kështu njihem me të.

Një herë, kur e përciellja për në shtëpi dhe tem-  
peratura e kohës ishte shumë e nxehtë, u sëmur pa-  
pritmas. Unë hutohem. Ajo zbehet krejt në fytyrë,  
frymëmarrja i vështërohet dhe gojën e mban gjys-  
më të hapur. «Artan, — më thirri në emër. — Vdi-  
qa! Vdiqa!... Ujë!!! Ujë!!!...» Nuk dija se çfarë  
të bëja. Ujë aty afër nuk kishte. Trupi i saj i nxehtë  
mbështetur mbi mua m'u duk se po më përvëlo-  
nte. Ta lëshoja në tokë e të vrapoja diku për ujë?!  
Po ku ta mbështeste kokën e saj të mirë?! Pranë  
stacionit u ndodh një vajzë dhe i kërkova ndihmë  
asaj.

Deri ato çaste Landa qëndronte mbi gjoksin tim  
gjysmë e këputur. E lëviza ngadalë dhe e mbështe-



ta në gjoksin e vajzës së mirë që na u gjend. Dhe renda, renda shpejt, diku, për të gjetur ujë. Disa minuta larg ujitej një arë e madhe me jonxhë. Atje derdhej një rrëke. Laga dy shami. Timen dhe të sajën. Në kthim renda më shpejt. Arrita me një frymë. Një shami ia vendosëm mbi ballë e tjetrën nën gushë e mbi gjoksin e nxehtë. Hapi sytë dhe më pa me dhembshuri. Ndjeva një vështrim ngacmues dhe mjekrra sikur m'u drodh. Për një çast ata sy sikur më dehën, më flladitën një pranverë lëndinash, një mërmëritje degëzash të reja, një kalitërsi të paturbulluar. Shamia ime e lagur dallgëzohet mbi gjoksin e saj të nxehtë. Bëra disa shaka, por ajo qeshi me zor. Ndoshta nuk mund të qeshte më tepër, se ishte e sëmurë. Unë desha t'i largoja tronditjet. Pas pak i ngrita dorën një ambulance ushtarake, që kaloi rastësisht aty. Hipëm. Edhe ajo vajza. Unë e Landa u ulëm në fund, pranë dritares, ku një freski e lehtë rrihte gushën e saj. «Ta mbyll pak dritaren», — i thashë. «Jo, — foli ajo. — Më zihet fryma. Kam vapë...» Trupi iu var shumë nga ana e dritares. I hodha dorën mbi supet dhe e mbajta fort pranë vetes. M'u duk se e shtrëngova fort, sepse ajo hapi sytë. (Mos e lëndova?!). Në atë përgjumje të lodhur, ngaqë ishte e sëmurë, lëshoi një buzëqeshje të ëmbël, por nuk tha gjë. Sytë e saj, të perënduar nga lodhja, ma zgjatën këtë buzëqeshje, si të hapnin një dritare për dritë dhe u mbyllën ngadalë si të më linin në një ëndërr mrekuillie. Ia hoqa dorën nga supi dhe ia vendosa mbi flokët e bukur e të ngatërruar, mbi ballin me lëkurë të lëmuar, por ajo sytë nuk i hapi. (Kisha dëshirë t'ia shihja sytë ato çaste). Megjithatë isha pra-

në saj, duke menduar se po ndihmoja një shoqe të mirë...

Këto mendoja tani, kur jam me njerëzit e mi dhe kur kam në dorë fotografinë. Landa ka veshur një pallto të shkurtër bojë bari me kuadrate. Ndothet pranë meje në krah të majtë. Të dy kemi qeshur nën një qershi me degë të pakta. Fotografia arrin në duart e babait tim. Ai rrin pranë vatrës. E mban pak larg syve dhe e kthen nga ana e dritës që ta shquajë më mirë. Fshin pak letrën llustër me duart e ashpra, të plasaritura, nga frika se mos i bën ndonjë vijë. Ngre vetullat. Rrudh ballin nga kontrasti i dritave.

E kujt është? — pyet ai.

Ja tregoj emrin, sepse babai e njeh prej kohësh të atin e saj. Dikur ai ka punuar traktorist në fshatin tonë.

— Cfarë shkolle ka bërë? — vazhdon babai.

— Ka mbaruar të mesmen dhe vazhdon të lartën me korrespondencë, si unë.

— Poo... Mirë, sikur... (Babai hesht një çast)

— C'të duhet me vajzat e botës të dalësh në fotografi?!

— Shoqe, baba, — i flas shkurt.

— Po nuk i dihet, — ia pret vëllai i madh. Mbase...

Më ishin lutur disa herë që unë të gjeja një nuse për shtëpi. Nëna tani lodhej më shumë. Dy vëllezrit e mëdhenj martuar e ndarë. Nusët shikonin më shumë hallet e tyre. I treti do të shkonte pranë të fejuarës, sepse ishte vajzë e vetme. Radha më mbetej mua dhe mbase kjo fotografi për ata... Por askush nuk flet. Askush nuk guxon ta përgojë shoqen time të mirë në këtë fotografi.

— Hë? — pyet përsëri babai.

— E kam shoqe, baba. E respektoj për shoqërinë tonë të mirë. Babai qetësohet.

— Mirë, bir! — flet me zërin e tij të shtruar.

— Ashtu. Mbajti dhe duaji shoqet.

Ne kemi një motër me shumë vëllezër. Shpesh ndjejmë mall dhe nuk flasim keq për vajzat. Asnjëri prej nesh. Asnjëri nuk guxon të thotë diçka tronditëse, as për Landën. Fotografinë vetëm nëna nuk e ka parë. E merr edhe ajo. E rrotullon disa herë në duart e saj të lodhura, të vrara, me gishtërinjtë e shpuar nga gjylyperat kur andron e rregullon rrobat tona, si ta dallonte më mirë dhe përsëri nuk kënaqet.

— Është e urtë? — pyet ajo.

— Është pak, — them unë.

— Po punëtore?

— Nuk e di.

— Ka merak?

— Nuk është keq.

— Duart i zënë? Si i ka? Flori?

— Nuk e kam parë.

Replikat e shkurtëra me nënën sikur kërkojnë të zbulojnë diçka. Edhe ajo më lutet të gjej një nuse dhe këtë mbase e kërkon tek shoqja ime. Por unë e kam shoqe dhe fotografia përveç miqësisë së mirë nuk tregon asgjë. Nënës i kam folur edhe më parë për shoqen time por ajo nuk është bërë kureshtare. Tani diçka e ndez në shpirt prej zemrës së saj, prej zemrës së nënës. Ajo më pyet e sytë lodhen nën dritën e zbehtë të dhomës, me shpresë që ta dallojë atë më mirë. Ata sytë e saj të mirë që po i afroheshin pleqërisë, që ishin dobësuar disi nga mosha

por nuk e kanë humbur kurrë ngrohtësinë e pa-  
shtershme.

— Hë?! — i thotë vëllai i vogël. Si të duket?!

— Nuk e shquaj dot, — thotë nëna. — Nesër,  
në dritë të diellit do ta shoh më mirë, — dhe e  
mori ta fuste në gji, atje ku ka një xhep të brend-  
shëm në trikon e leshit, që mban fotografitë më të  
shtrenjta, ato që kërkon t'i shohë me mall çdo çast;  
të mëmës së vet e të vëllait tonë të vdekur, që pati  
një jetë fare të shkurtër.

— Të pëlqen? — pyet prap vëllai i vogël.

— Po nuk e shquaj dot të mirën.

— Parë Floreshën, ke, — i thotë babai.

Floresha, motra jonë e vetme, e rritur më tepër  
larg syve tanë. Motra ka qenë e bukur, po, po.  
Më e bukur se Landa.

— E, mirë, — thotë ime ëmë. Nesër, në dritë të  
diellit... — dhe deshi ta fuste në xhep.

— Do ta thyesh, — i flas shkurt.

— Ruama e ma jep nesër, — porositi ajo dhe e  
lëshon në duart e mia.

Landa vjen përsëri tek unë. Mbesa e vogël i ka  
bërë librat si mos më keq. Kjo s'më mërzi, biles  
sikur më shplodh pak kjo rrëmujë. I fus në çantë  
bashkë me fotografinë që e kam të ruajtur në mes të  
bllokut. Askush nuk më ngacmon më për këtë. Fun-  
dja ajo është shoqja ime...

Të nesërmen nisem herët për në punë. Nënës  
harrova t'ia lë fotografinë. Këtë e bëra vetëm nga  
nxitimi. Ajo ruhet thellë në bllokun tim me ngrohtë-  
sinë e çiltërsinë e miqësisë sonë. Në shkollë tako-  
hem me të gjithë kolegët. Landa këto ditë sepse  
mban një shqetësim, por nuk flet. As unë nuk e  
pyes. Më shikon me bisht të syrit sikur kërkon të

më rrëmbejë diçka. I buzëqesh si zakonisht; aq lehtë sa askush nuk mund ta kuptojë veç saj. Një buzëqeshje delikate që kishte gjetur shteg në brendësinë e shpirtit të Landës. Para se të bjerë zilja e fillimit të mësimit janë futur në klasë. Do të bëj një kontroll në lëndën e gjuhës. E di që Landa është bosh në këtë orë mësimi. Vjen në klasën time dhe ulet në tavolinën e mësuesit. Ajo luan me çantën time, por unë nuk i kushtoj shumë rëndësi. Del përsëri. Në fund të orës së mësimit më thotë:

— Fotografia që kemi dalë bashkë nuk më pëlqen. Do ta gris!

— Si?! — u çudita unë e pastaj shtova me pak buzëqeshje të çiltër. — Do të bëjmë ndonjë tjetër?!

— Jo. Kurrë. E përse duhet të dilnim bashkë!

— Thjesht për shoqëri, — ia pres shkurt por edhe me një inat të ndezur në vetvete që nuk e kam shprehur.

— Shoqëria mjafton me fjalë, — ma pret ajo.

— Po kjo që kemi bërë në ruan kujtimin e viteve, — vazhdoj.

Fjalët shumë shpejt harrohen, ndërsa ajo do të mbetet shenjë e miqësisë sonë të mirë.

— Jo, — flet gjithnjë e më shkurt ajo. Unë për vete do ta gris ose do ta djeg. Edhe ti...

— Nuk do ta bëj këtë gjë, — i them. — Fotografia nuk e bëra që t'u them të tjerëve me mburrje se jam një donzhuan, se unë të kam pasur si dashnore, kam kaluar kohën me ty. Jo. Gjithmonë si shoqe të mirë.

— Askush nuk do ta besojë këtë, — thotë ajo me pak zë.

— Ç'dreqin ke?! — gati sa nuk i bërtas unë.

— Bota flasin... Më merr nëpër gojë... Ti...

— Më paske kuptuar, — i them dhe largohem për një çast duke lënë çantën në sallë. Kthehem vonë. Çanta ime ka lëvizur. Mbase nxënësit që kanë bërë pastrimin, mendoj me vete dhe nisem për në dhomë. Në mbrëmje nxjerr bllokun nga çanta. Fotografisë dua t'i shkruaj datën, emrin e Landës dhe një dëfturë. Për çudi blloku nuk ka asgjë. Ajo është grabitur dhe vendi ku unë e ruaj më duket i ftohtë. Diçka po gremiset shpejt e pa kuptuar. Gramarr me mend se ç'mund të ketë ndodhur. Grabitësja e shoqërisë është Landa. Hendekun e miqësisë ajo e hapi fare pa shkak. Kujtova se mos ia kam bërë borbh dikujt. Jo. Gjithmonë ajo ka gëzuar nga unë simpatinë e sinqeritetin e zemrës së çiltër. Të nesërmen e pyes:

— Përse veprove kështu?

— Për të ndrequr atë hap të gabuar. Ndoshta...

— Mos do të thuash për të gjitha ato që kemi biseduar?! — e ndërpres unë.

— Jo. Vetëm fotografia. Shkakun është ky. Ti ke shumë vëllezër. Të gjithë në fshat. Çdo të mendojnë ata për mua?! Shumë vëllezër. Mbase kultura u... u mungon dhe do të flasim keq. Më mirë kështu. Të dyja fotografitë i dogja sot në zjarr.

— Si?!... I dogje?...

— Po.

— Më fal për të gjitha, — i them dhe largohem.

Nuk dua këtë çast të jem me të. Për pak kohë le të ndodhem vetëm. Më kujtohen vëllezërit e mi që nuk folën asnjë fjalë të keqe për të, babai që e krahasoi me Floreshën, motrën tonë të vetme; nëna që nuk e shquante dot dhe do të priste dritën e diellit në agimin e së nesërmes...

Në fund të javës marr rrugën për në shtëpi. E di që nëna më pret të shikojë fotografinë. Do të jetë errësuar dhe përsëri do të presë agimin e ditës tjetër. Për të mos e harruar, si radhën e parë, do ta mbajë në xhëpin e trikos. Po çfarë t'i jap?! Si t'i them?! Ajo vetë do të ma kujtojë por unë bllokun e kam bosh, të ftohtë dhe vetë me një ftohtësi tjetër në shpirt, me një vegim të plagosur në shoqërinë e saj. Eci dhe mendoj se çfarë t'i them nënës sime të shtrenjtë.

Çfarë t'i them?!...

## NATA E VETME

— Do të vish pa u lutur shumë?

— Ku?

— Ku! Sikur s'e di ku rreh çekani! — dukej sikur fliste me zë të ulët e lutës kushëriri im Qamili.

— E di që ai e do një dru të mirë, por sikur s'vete, — mbrohesha unë.

— S'vete?! Po ai është kurvar, është qen!

— E pastaj?!

— Ta bëjmë të lëpihet, i biri i bushtrës!...

Në heshtje, ende nuk po merrja një vendim të prerë për ato që më thosh-Qamili. I mbështetur mbi murin e kopshtit të tij, me një guriçkë gërvishja kot mbi një dërrasë prej guri. Kushëriri im, që ishte më i gjatë se unë (megjithëse isha dy vjet më i madh), shtërngonte dhëmbët. Vinte pak esmer. Flokun kaçurrel dhe të dendur e mbante të paqethur. Nga shëndeti unë vija më i mbushur. Punëtor ishte më tepër se unë. Fillimisht, kur do të dilte në punë, më tha se në cilën brigadë është më mirë. I mburra timen. Atje kisha dëshirë të vinte e bëheshim të dy një dorë e mirë që s'do e çanim kokën fare. Shkonim ca larg, por punët i kishim të lehta.

Zakonisht ai e dëgjonte fjalën time e nuk ma prishte. Por ndonjëherë, kur ngulte këmbë si mushka, hajde të merreshe vesh me të. Edhe sot, që bi-



sedonim tek muri, ai ngulte këmbë në të tijën e s'po mundja t'ia ktheja mendjen.

— Mos ma prish! — theu heshtjen ai.

— Po sikur...

— Çfarë sikur?! Unë të kam dëgjuar sa e sa herë. Edhe kur shkuam tek Sulët, erdha se deshe ti... Ti, tani, nuk do të më ndjekësh?

— E lëmë për më vonë.

— Kur? Kur të na i plasi dobiçin në shesh?!

Hajde kusho, hajde!

— Jo more?!...

— Po pse, kot them unë, o sot, o ska?! Nesër atij i mbaron leja e shkon në repartin ushtarak. Atëherë na rroftë muhabeti.

Më vinte inat edhe mua në fakt. Ai më ftonte që të rrihnim një çun nga fshati, i cili e kishte shtëpinë në lagjen përballë tonës. Ky dashuronte motrën e Qamilit. Në fshat fjalët kishin marrë dhe në e me sa duket kishin rënë edhe në vesh të Qamilit. Ai më pyeti mua me terezi në se kisha nuhatur ndonjë gjë për këtë muhabet. Dhe kur e mori vesh se unë isha në brendësi të meselesë, vendosi të merrte hak. Rita, motra e tij dhe kushërira ime, ishte një vit më e madhe se unë e tre vjet më e madhe se Qamili. Edhe unë kisha frikë se mos djallosej puna e na mbetej ndonjë dobiç në derë. Se i thonë dobiç në fshat, or babaxhan e jo si nga qyteti, që s'merret vesh se kush e bëri e ku e bëri. Tek ne edhe mullarët e barit të njohin. Po t'ia ngecte ai rryçua, që ishte ushtar e ta linte, ku mbeteshim ne? Edhe ishim gjithë ata kushërinj, që po të shtinim në dorë, nuk e gdhije mëngjesin. Por Qamili fillimisht kishte vendosur që këtë punë ta bënte

vetëm me mua dhe natën. Unë s'vendosja dot.

— Hë?! E mbushe rradaken?! — më shkuli nga mendimet.

Tunda kokën e ngrita vetullat.

— Si të duash, por nuk bën mirë të mos vish.

— Po si ta rrahim tjetrin...

— Zor për kërbaç, thuaj ti?! I bie unë. Ti hajde rri afër, se edhe më i rritur je.

— E ç'të bëj?!

— Kur t'i bie unë, shikoje mirë se mos më bën ndonjë saltro apo kapje nga ato që ka mësuar në ushtri. Se atje thonë që mësojnë saltro për të kapur diversantët. Po ta shikosh ti se më bën mua gjëra të tilla, këputja nga pas...

— Po sikur ai ta dojë Ritën me të vërtetë?!

— Pse o, tek harbutët do ta jap motrën unë?!

— E hu, ku ka më harbutë?!

— S'bëhet lis rigoni. Harbuti harbut mbetet.

— Po Rita të është ankuar, — fillova unë t'i bëja ca pyetje për ta zbutur që të mos dilnim atë natë për sherr.

— Të më thoshte mua ajo gjë për atë, nuk i mbushte njëzet e katër orë, — vazhdoi ai me inat duke shtërnguar dhëmbët. — Ia shtypja kokën si të kërmillit.

— Ajo ka rrezik ta dojë vetë, — e ndërpreva.

— S'ma merr mendja, — tha kushua i vendosur.

— Domethënë e ke vendosur për sot?! — pyeta i lodhur.

— Po po, — foli prerë. — Edhe sikur të mos vish ti, do të shkoj. Më s'të lutem. Po deshe hajde. Ne jemi gjak. Turpi i shtëpisë sime është edhe tëndi...

— Ku do të dalim? — u dorëzova pa kushte.

— Ja këtu. Në këtë rrugicë. Në mbrëmje ajo kthehet nga provat e teatrit. Ai e sjell deri këtu dhe kthehet. Kur të niset lart, ne zbatojmë planin, i bëjmë nënën, i bëjmë. Kur ta kujtojë t'i dridhet mishtë.

— Mirë, — ia dhashë fjalën, por i pasigurtë. Ai si nevrík që ishte mund të bënte ndonjë marrëzi. Hëngrëm darkën shpejt e shpejt nëpër shtëpitë tona dhe dolëm në pritë. Dikush do të na e quante për turp, por ne u ngjanim kaçakëve dhe na bëhej qejfi kur të merrej vesh gjëma jonë. Pleqtë e fshatit do të na quanin tamam burra, se po ziheshim për çështje nderi e fisi. Një frikë tjetër më bënte të rrija edhe i druajtur. Po sikur ta godisnim në ndonjë vend të lig, nga lulet përshembull?!... Hata do të ndodhte. Nxora paketën dhe ndeza një cigare. I dhashë edhe një Qamilit.

— Nuk dua, — tha. — Edhe ti fike se na shikon njeri.

— Punë e madhe! Se mos e dinë ata përse kemi dalë ne.

— Unë po shkoj tek shtegu sipër, ndërsa ti këtu. Kur të kthehet lart, hidhu në rrugë. Kujdes, jo leshko! Edhe mendo se ç'salto ose sambo mund të na bëjë. Ah, po s'ia lëruam nënën...

— Mirë, mirë, — u përgjigja dhe ndërsa ai ikte, mendoja se mos më bëhej ndonjë saltro mua.

Vendi ku isha fshehur ishte afër shtëpisë sime. I shtrirë e gjysëm i mbuluar afër mënit tim të madh, s'pipëtija. Më tej ishin ca gurë që do të bënim kasollen e lopës e pak më tej mullarët e barit. Një pjesë e barit nuk ishte vënë mullar. Nata ishte e freskët si natë gushti. Hëna ndriçonte dobët. Ne prisnim, ndërsa ai po vonohej me gjithë Ritën. Qa-

mili ishte gati tridhjetë metra larg meje, në kopshtin e një komshiu. Ishte hedhur brenda gardhit dhe përgjonte pas tij. Me vete mbante edhe një shkop prej shkoze. Komshiu, ku përgjonte Qamili, kishte një qen të madh, që të hante. Ç'është e vërteta qentë i kisha qejf, por jo aq të egër sa të hantin njerëz. Pas pak, Sadiku ndezi dritën e verandës dhe zgjidhi qenin nga hekurat. Qamili e parandjeu të keqen dhe u sul mbi gardh. Kur po hidhej, qeni e nduku në këmbë të pantallonave. Shpëtoi mirë dhe erdhi pranë meje i mërzhitur duke rregulluar pantallonat.

— E hëngërt një ujk! Ja kështu! Shiko si më grisi, — dhe më tregoi pantallonat që i ishin bërë copë në një rën këmbëz.

— Pó tani? — fola unë.

— Do të rrimë edhe pak bashkë, — u përgjigj ai.

— Këtu?!

— Po.

— S'do të shkosh në shtëpi?

— Jo.

— Pantallonat i ke copë.

— S'ka gjë. I qep më vonë. Bëj pak më tutje.

— Pse?

— Të shtrihem edhe unë.

— U bëmë derr. Kemi dy orë që presim.

— Tani duhet të vijmë.

— Ndoshta...

— Në këtë orë vjen zakonisht, — përfundoi Qamili dhe shtriu krahun mbi mua. Shkopi i shkózës më vrau pak në kockë.

— Do t'i biesh me këtë?

— Ky të shtron.

— Flake më mirë.

— Jo.

— Nuk ka lezet. Hidhe se jemi dy veta.

— Po s'ia gdhenda kurrizin unë, po...

— Me këtë nuk të lë të qëllosh.

— Mirë, o mirë, — kërkoi t'i jepte fund ai bisedës dhe u ngrit në këmbë.

— Ulu!

— Ja, — ma ktheu. — Tani sikur i ke parë. Po të rrimë të dy këtu ka rrezik të na ikë. Unë po hidhem tek avëllia e Azisit. Kur të niset ai lart, ti fërshëlle dy herë dhe nisu pas tij. Unë ia zë pusinë atje. Mirë?

— Mirë.

U ndamë. Ai kapërxeu murin e lartë në krahun tjetër të shtëpisë së Sadikut, duke u hedhur në obo-rrin e Azisit. Shtëpia e Azisit nuk kishte qen. U mbulova më tepër me maja misërishtash dhe u bëra rrafsh me tokën duke bërë veshët pipëz.

Ata erdhën të dy me hapa të lehta pa menduar se u ishte ngritur prita nga dy kaçakë si ne. Ecnin të sigurtë. Ngrita kokën se mos ishin të tjerë, por jo. Ishin ata që prisnim. Rita ecte e mbështetur në supin e tij, ndërsa ai se çfarë i pëshpëriste. Unë s'pipëtija, se një çikë të lëvizja bënin zhurmë majat e misrit. Për bela qëndruan tek mëni afër kokës time. Ia nisën bisedës. Kur të ndaheshin unë do të jepja sinjalin.

— Babai vjen sot në shtëpi? — pyeti ai.

— Duhet të ketë ardhur.

— Të vij në shtëpi dhe t'i them se unë dua vajzën tënde?...

— Jo.

— Pse?

— Ai do të zemërohet keq. Do të më rrahë.  
— Ti më do mua? Përse trembesh?  
— Të dua, por Qamili më qëlloi dje.  
— Si?!

— Më rrahu!

— Kjo nuk durohet!

— Më tha se do të zihet edhe me ty.

— Le ta provojë me mua po të dojë. — ia ktheu ai. Mua më shkoi mendja menjëherë se ai do t'i bënte saltrot. Më shkuan të dridhura.

— «Mos e bëj këtë! — lutet Rita. — Ai është vëllai im.

— Ai pse të qëllon ty?

— Është nevrik.

— Nuk do zgjatur më. Do të vij në shtëpi.

— Nuk të besojnë.

— Kurrë mos besofshin. Atëhere do të të rrëmbej dhe po të duan le të më dalin përpara».

Bo, bo, thashë me vete, kushedi sa kapje ka mësuar ai në ushtri, që s'paska frikë nga asnjëri. Mua më bëhej se edhe majat e misrit do të lëviznin që të më zbulonin. I pari do t'i provoja saltrot unë.

Nga kreu i rrugës u dëgjuan hapa. Nisi vallja, thashë me vete. Qamilit s'i është duruar dhe është hedhur.

«— Babi!» — foli ajo e friksuar dhe rendi drejt meje.

Agroni e ndoqi nga pas. U fshehën mbas mënit tim të madh, afër kokës sime. Rita u ngjesh atje dhe as fryma s'i ndihej sa kaloi i ati poshtë. Pastaj u çlirua duke nxjerrë një gjyryk fryme.

«— Përse ike? Gjer kur do të rrimë kështu?!

— Ah. Gone. Gone! Sa të dobëta tregohemi ne vajzat», — foli Rita me zërin që po i dridhej.

«— Si? Rita! Ti po qan?!

— Dridhem e tëra! Dridhem Gone».

Ai i lëshatoi flokët. I mbështeti pëllëmbët mbi faqe. Ia rrëshqiti ngadalë dhe i fshiu lotët. Pastaj e përqafoi fort. U puthën gjatë. Po kur puthte edhe ajo. Hajde budalla, i thashë vetes. Kujtove se i shpëtove filmave me puthje në televizor. Këtu u puthkan mu tek koka tënde.

Ai pastaj e mori në krahë dhe shkoi rrëzë mullarit, ku kishte edhe pak bar pa u tharë mirë.

— Cfarë bën? — foli me zë të prerë fare ajo.

— Do të shtrij këtu! — tha ai.

— Mos! — iu lut e trembur kushërira ime.

Ai e shtriu nja dhjetë hapa larg meje, ku ndodhesha i mbuluar me maja misri. Nuk e vura re a e shtriu me saltro mbi barin e patharë mirë. Pashë që ai u shtri mbi të dhe e puthte si i ndezur në zjarr. Ai donte t'i ngrinte fustanin e ri. Ajo kundërshtonte, por me zë të dobët, sikur edhe ia kishte qejfi...

«— Mos. Goni, mos! E kam fustan të ri.

— Ngrije lart të mos bëhet pis».

Ajo largoi duart dhe ai ia ngriti vetë, sikur edhe duart tek gjoksi do t'i fuste që nga poshtë. U zbuluan kofshë të bardha. Ai filloi t'i puthte dhe kofshët e saj. Bobo ç'saltro paska mësuar ai! Pastaj se ç'bëri me këmbët e saj, i vendosi mbi krahët e tij dhe filluan të rënkonin të dy. Ajo qau pak. Ktheu kokën mënjanë, por ai ia mori me të dyja duart dhe i puthi fytyrën dhe flokët. Pastaj këmbët e saj u ulën.

«— Po tani?! — u ndie zëri i mekur i Ritës.

— Do të shkojmë bashkë në shtëpi».

U rregulluan shpejt e shpejt dhe u nisën. Sa u

zhdukën ata, unë s'leviza. Film të tillë as në televizor nuk kisha parë. Meraku se si e shtriti, me saltro apo pa saltro, më iku. Rëndësi kishte që ia bëri të fundit.

Kur u binda se ata kishin ikur, u ngrita dhe i fërshëlleva Qamilit. Ai u ndodh menjëherë në rrugë dhe bërtiti.

— Qën! Qën bir qëni! Ku do të vesh tani?!

M'u qesh, por s'nxorra zë. Ai kujtoi se Agonin e kishim në kurth.

— Kot që thërret! — i thashë.

— Pse?!

— Ai po ikën drejt shtëpisë tënde...

— Ashtu?!

— Duhet më duket.

— Këtu sikur u llafosën gjatë.

— Posi. Të gjitha i dëgjova.

— Ç'thanë?!

— E ç'pyet. Tek mëni e tek bari u shtritën.

— U shtritën?!

— E.

— Ai e rrëzoi?

— Nuk e pashë mirë.

— Mos e hodhi me saltro, qëni?!

— E, e, saltron ia bëri të mirë.

— Po tani? — pyeti si i pikëlluar që s'bëmë dot gjë e dualëm gallof fare.

— Do të shkojmë në shtëpi dhe më s'dalim.

— E ç'të dalim...

— Dhe filmat do t'i ndjekim të gjithë. Të gjithë e jo vetëm ata me shpatë e mitraloza. Kjo le të jetë nata e vetme.

Ai heshti. U ndamë. Secili do të shkonte në shtëpinë e tij. Qamili e flaku shkopin mbi barin



tim, që s'ishte tharë mirë, atje ku Agroni bëri saltron e parë. Qamili ecte dhe mbante me dorë pantallonat e grisura. Nga pas i shkoi konia ime e vogël, një qen bardhosh e leshator. Ai lozte nëpër këmbët e tij.

**Tetor 1985**

## DYFEKPLASURI

Mëngjesi ishte mbyllur nga të katër anët. Kullonte një shi i shtruar e lozte një mjegull e dendur. Ai s'mund të rrinte. I trokiti tek xhami brigadierit të arave e ai që brenda, pasi ia njohu zërin, i tha të nisej te Vlaget për të kulluar fundin e arës. Ajo s'rriste grurë të mirë se mbetej gjithmonë si moçal. Asnjë tjetër s'doli në punë, ndërsa ai rrëmbeu lopatën, një pallto copë-copë dhe bëri poshtë.

— Ku shkon? — e pyeti Etemi, kushëriri i tij që nga ballkoni, i veshur me një pallto shajaku të re.

— Në Vlaget.

— Për ta kulluar?

— Ee.

— Paske marrë edhe qenin me vete?!

— Më ndoqi.

— Kthehu! Sot nuk dilet jashtë. Qamet! Qamet i madh!

— Ku di barku i kalamajve qamet, o Etem!...

Bedriu u zhduk mes mjegullës, që e mbështillte me të ftohtin e saj. Qeni i madh pullali nuk i ndalej asnjë hap. Mbante kokën ulur, si të nuhaste hapat e të zot. Dhe më të rrallë kthente kokën majtas e djathtas. Bedriu, pa arritur tek puna, ndjeu të ftohtin në shpatulla dhe njëren çizme të fuste ujë. Duke vështruar nga perëndimi për parashiki-

min e kohës, që po mbyllej më tepër, ofshau me shpirt të lagur. Mjegulla shtohet. Ktheu kokën pas dhe ndali. Edhe qeni pullali, si i frikur, qëndroi e bëri një hap mbrapa. E kishte marrë për të mos e kthyer më. Do ta vriste tek rripa e Maksutit, pasi ishte plakur e lehte më të rrallë. Qeni vështroi të zotin dhe tundi kokën si të thoshte: «Do të ndjek e të ruaj nga pas, se gjithë jetën këtë punë kam bërë». Pastaj vështrimi i qenit mbeti i ngrirë, këq-ardhës. Bedriut i ra një pikë e madhe në zverk, luajti qafën dhe u nis mes përbaltjes. Mjegulla herë shpërndahej e herë mbyste gjithçka si zotëruese e hapësirës. Herë vinte me shiun e herë e vetme, me një ftohtësi mospërfillëse. Kur largohet ajo, ajri dukej se ishte çliruar e larë i gjithë, si të kishte dalë nga një banjë e gjatë. Pemët e zhveshura më pas fshiheshin përsëri nga mjegulla e dendur që lëvizte si pa fre nga veriu, drejt jugut, duke u puthur herë pas here edhe më retë e vjesh-tës së pasme. Re që ende nuk donin ta mbaronin së zbrazuri barkun e mbarsur nga shiu. Bedriu, që ende s'i ka mbushur të pesëdhjetat, i mëshon lopatës me vrull. Balta e madhe e detyron të ndër-prisë punën disa herë e të shkundë lopatën herë mbi gur e herë me një copë shkop prej thane. Fillon fërshëllen edhe një erë e hollë. Tunden degë të zhveshura, bien gjethe të zverdhura dhe lakuri-qsia e ftohtë e pemëve shtohet. Retë, shpuar tej për tej, duken të zemëruara. Në mesditë ndezi një flakë zjarr nën gorricën që ndodhej pranë. Kokrra të rralla gjysmë të kalbura, gjysmë të verdha gjëndeshin në tokë të mbuluar me pak dhe. Mblodhi një grusht e u nis t'i lante në një pellg me ujë. Shiu ishte prerë. Mjegulla shkante e vinte si të ki-

shte ditën e saj. Qeni rrinte buzë një ledhi disa metra larg, nën një pjergull, e duket së s'bën më roje, por dremit i lodhur e i sigurt se të zotin e tij nuk do ta gjejë asgjë. Si i lau gorricat, Bedriu filloi t'i brente me ngadalë. Vendosi copën e bukës së misrit për të thekur. I hodhi një kafshatë qenit, i cili e futi mes këmbëve me dremitjen e tij përtaçe. Pas pak era e bukës së thekur i ngrohu barkun. Hodhi pallton mbi kokë. Nuk i ndjeu hapat që iu afruan.

— Po e thek, ë?!

Ai ktheu kokën. Ishte kryetari i kooperativës, që s'kishte mbushur ende të tridhjetat.

— Hë! Edhe në shi, o Bedri?! Ruaje veten. Shëndeti, Bedri, shëndeti! Për këtë luftojmë edhe ne që drejtojmë.

— Urdhëro, o kryetar, urdhëro!

Kryetari u afrua, por s'mori asnjë kafshatë buke, Çizmet e reja, pellushi i ri, triko e leshit e re, dorashkat e veshura për herë të parë e bënë të mos e ndiente të ftohtin aspak. Bedriu duke u përtypur pa veten dhe atë. Para se të bëheshin kooperativë i ati i kryetarit kërkonte ndihma te babai Bedriut. Kohët kishin ndryshuar. Flitej për rritje të mirëqënies, por ky s'e kuptonte se ç'rritje qe kjo. Punonte sa krahët e tij e dinin. S'ia hante qeni shkopin për punë, por s'shihte ditë të paqme.

— Paske dalë sot?

— Duan bukë fëmijët, kryetar!

— Të kanë mbetur ndonjëherë pa të?!

— Aty afër, po s'po i ngop njëherë të shkretën.

— Ashtu, ë?!

— Posi, ore. Tërë verën më shumë hanë mëna

sesa bukë. Pale për të veshur e mbathur, mos më keq.

— Je dobët. Je ca dobët, je, po ata vëllezërit tënd rrojnë mirë ama.

— Çka, çka. Edhe keq s'janë. Kthehen ata, së kanë edhe ndonjë rrogë në shtëpi.

— Edhe një derr u mungon atyre, ndërsa ti hiq e mos këput.

Bedriut i erdhi mirë që kryetari ia qau hallin si njeriu i zemrës dhe iu duk i mirë. Fjalët që atij i pëlqenin, sikur po ia largonin të ftohtit e qullur.

— Ata dinë të gjejnë qoshe, — vazhdoi kryetari për vëllezërit e Bedriut. — Ti...

— Edhe ç'të punuar që bëj unë, o kryetar! Po s'qas, s'qas tek unë.

— Vëllezërit s'të hedhin ndonjë krah?

— Ja më hedhin, por s'mbahet shtëpia me miell hua. Kanë hallet e tyre ata.

Mjegulla po vinte përsëri si e shkrehur me vrap nga era. Mbuloi gurin e Galinës dhe u shtrua tek Gropa e Lisit, si të shtronte përgjithmonë qilimin e grisë së madhe. Ajo kërkonte të thithte diçka nga qënia e të dy burrave që ngroheshin. Kryetari hapi çadrën dhe pikat e shiut binin mbi zjarrin e Bedriut. Buka, një copëz bukë pranë zjarrit, thekej e lagej.

— Nuk pati ndonjë punë afër? — ngaçmoi bisedën kryetari.

— Jo. U poqa me brigadierin dhe...

— Mbarove për sot?

— Kam edhe një copë. Të pres ato ferrat në fund të ledhit që t'i nxjerr grykën kanalit. Mban shumë ujë ai fundi atje.

Kryetari shikonte zjarrin që po zbehej dhe më

pas Bedriun që ishte qullur i tëri dhe vazhdonte të lagej. Nuk kishte rast më të mirë për të fjalosur me Bedriun problemin e tij. Mendonte se uji që i kishte hyrë në palcë do ta shtynte të kryente porosinë e tij, ashtu si kryente vetë ai porosinë e më të mëdhenjve kur vinin nga larg. Kryetari zgjaste zinxhirin, por duhej të zgjidhte edhe kush duhej futur nën zinxhir. . .

Një pikë e madhe shiu u këput nga degët e gorricës dhe ra në majë të hundës së skuqur të Bedriut. Gorrica shtoi pikat.

— U shtua shiu, Bedri, — qau hall kryetari.

— Kështu ka qënë gjithë ditën sot. Njëpër shi e kam bërë punën, — ia ktheu Bedriu dhe futi në çantë nga dy koricë buke. I hodhi qenit plak pullali edhe një copë tjetër pak të djegur. Kryetari ndiqte veprimet e tij dhe ende s'po e gjente shkakun të zbrërthehej. Në vend të fjalëve, i buzëqeshte matur, fërkonte duart. Bedriu u shkund.

— Mirë mua halli, po ti pse u mundove? — pyeti kryetarin.

— Të shikoj arat, se ata qerratenj brigadierë edhe gënjejnë ndonjëherë.

— Me demek as ata s'thonë të vërtetën?

— Të vërtetën mund ta thonë vetëm njerëz si 'ti. — ia bëri qejfin kryetari. — Ti je i thjeshtë, i ndershëm. Atë që sheh ta përplas në fytyrë.

— Për gënjeshtër s'më ke mua, — çiltërohet me të vërtetë Bedriu dhe u shkund baltën çizmeve të grisura.

— Njerëz të tillë na duhen sot. Dhe po të jesh kështu gjithmonë ne të ndihmojmë. Të rregullojmë ndonjë punë të mirë.

— Punë të mirë, thotë! Po unë s'kam as shko-

llë e as zanat. Vate puna ime. Të shtrengoj bish-  
tin e lopatës...

— Dëgjo, dëgjo mua. Ka edhe punë këmba  
mbi këmbë.

— Jo, ore?!?!

— Ka.

— Hë?!?

— Si shkon me vëllezërit ti, Bedri?!

— Unë?!?

— E?!?

Bedriu ngriti supet.

— Unë e di që vëllezërit nuk të shikojnë me  
sy të mirë, — vazhdoi kryetari.

— Pse?!?

— Sepse njerëzit e gruas tënde, — dhe tundi  
kokën me kujdes, — janë të deklasuar.

— E po ç'kanë bërë të zeztë, — shtoi keqar-  
dhjen me zemër të pikëlluar Bedriu.

— Ne e dimë. Dokumentat i kemi të gjitha.  
Cëk cëk një më një i kemi. Ahu ne...

— Lëre atë mesele, aman, — u duk se vazh-  
doi dhimbja thellë në shpirtin e Bedriut.

— Ama, shtëpinë, fëmijët, gruan e ty, kjo me-  
sele ua shkatërroi.

— Eh! Eh e vilanosura! Kjo, kjo më ndjek si  
qen i tërbuar në kohë të mira e në shi si sot. Mbe-  
ta unë i ziu, mbeta! Më thonë mirë mua ashtu...

— E. Ata, tët vëllezër të kanë thënë që ta lije  
gruan, ë?!?

— Më thanë.

— Ee. E dimë edhe këtë. I kemi të gjitha ne.  
Të gjitha të shkruara.

— Unë s'e bëra dot, se, atë fat pata.

— Edhe këtë e dimë që e ke thënë. I kemi të

gjitha të shkruara ne. Çek, çek, një më një.

Rigonte shi. Degët e goricës, disi të nxira, pikonin sumbulla të mëdha shiu. Kryetari, brenda rrobave të reja, ishte valë i ngrohtë. Bisedën e vuri në lëvizje dhe pas pak do të zbërthehej i tëri. Tymi i zjarrit të paktë e ndiqte ndonjëherë si me zvarritje dhe e detyronte të fërkonte sytë që i nxorën pak lotë.

— E, Bedri, Bedri... Kështu vëllezërit tënd.

— E po ç't'u bësh. Zjarrin e vatrës sot e kanë më vete. Ata e dinë kur e mbajnë ndezur. Edhe këtë ju duhet ta kini të shkruar.

— Posi, posi. Ata të shikojnë vëngër. Bile edhe një pjesë e fshatit me kohë të shikon me inat, si të jesh edhe ti familje e deklasuar e jo që ke një xhaxha dëshmor.

— Rrokullimë, thuaj, rrokullimë e shkreta jetë! Kryetarit i erdhi çasti.

— E di ç'të bësh, Bedri?

— Hë?!

— Edhe ti bëhu i gjallë. Kusur mos u lër.

— Si, kundër?!

— S'do shumë punë. Ka nga ata që flasin mbarë e prapë gjithë kohën.

— E di, e di, — ndërpreu Bedriu, — më shajnë mua.

— Lëre veten tënde. Shajnë të tjerë më të mëdhenj. Qeveria ka organet e sigurimit, pa mbahet në këmbë. Ka policinë e ç'nuk ka. Njerëzit në fshat, siç e thashë, edhe flasin, shajnë rendin tonë përparimtar e revolucionar. Hë?! — kërkonte kryetari miratimin e fjalëve nga Bedriu, që ishte lagur i gjithë dhe po i hynin mornica në trup. Pastaj vazhdoi:

— Ti me ata jeton. Dëgjon dhe ngacmoi. Pas-



taj, të gjitha ç'të dëgjosh m'i raporto mua në fillim që t'i shpiem atje ku duhet. Në Degën e Brendshme. Ata pastaj bëjnë punën e tyre. Më kuptove?!

Hiri i paktë dhe i ngrohtë ishte lagur i gjithë. Bedriu lagte buzët me shiun që i varej nga faqet.

— Punë me leverdi është, — vazhdoi kryetari. — Edhe për vëllanë tënd, që s'të lë një minutë rehat, të jesh sy e vesh hapur. Janë të dyshimtë ata. Sidomos ai që u përjashtua edhe nga Partia jonë e lavdishme.

Bedriut i ishte tharë i gjithë kurrizi dhe këmbët e mpira po akulloheshin gjithnjë e më shumë brenda çizmeve. Shiu e mjegulla shtoheshin. Gryka e pahapur e moçalit, ku punonte ishte mbushur plot dhe ujërat e turbullta ishin plasur mbi njëri tjetrin atje.

— Nuk del keq. Për këtë paguhesh nga të tjerët.

Bedriu futi duart në hirin e zjarrit, por ai s'ish-te i ngrohtë.

— Paguhesh mirë. Nja dy mijë lekë në muaj. Bedriu hoqi duart nga hiri i ftohtë.

— Jo kryetar, jo. Nuk ë bëj dot.

— Do të ushqesh kalamajtë, ore.

— S'i mban fëmijët leku i tillë.

— Kështu do të rrish gjithë jetën?!

— Jo. Sa të më rriten djemtë, pastaj punoj me ata. Atëherë më ndryshe do të jem. Brekëgri-sur i kam sot, por do të bëhen nesër.

— Do t'i vdesësh për bukë. Edhe vetë do të vdesësh me ata.

Kryetari shtërngonte pellushen e ngrohtë të mos i hynte të ftohtit.

— S'lë Qeveria, kryetar, që të vdes njeri. Ohu, kjo qeveri i ka të shkruara të gjitha.

— Po edhe unë për qeverinë them të punosh.

— Të tilla punëra s'i bëj dot, kryetar. Nuk na e ka hequr konaku për të mbjellë gjëra të tilla. Hallall e kam bishtin e lopatës.

Kryetarit s'ia priste mendja ta kundërshtonte Bedriu. Tre ditë nëpër fshat ai me këtë punë ishte marrë, më me ngut se asnjëherë tjetër. Të gjente tipa përgjues për çdo fis dhe t'i shkonin punët më mirë fshatit. Kishte gjetur të moshave të ndryshme. Por ata, që ia donin këtë punë, i thanë që të shikonte për njerëz pa parti e disi të prekur në biografi. Tek këta, ku bënte pjesë edhe Bedriu, mund të bëhej punë më shumë. Edhe kryetari kështu mendonte, por ai s'bindej.

— Hë?! — e ngacmoi përsëri.

— Nuk ha bukë ashtu unë.

— Po edhe kështu s'po e mbush barkun.

— Më mirë.

— Mbetë, Bedri, mbetë dyfekplasar, o i zi.

Bedriut i thoshnin me kohë «dyfekplasar», nga që ishte rrënuar nga ekonomia në shtëpi. Ai atë çast mendonte për fëmijët, që me siguri ziheshin me njëri-tjetrin. Ziheshin gjithmonë ca nga të ftohtit e ca se ishin zbrazur nga barku e zbathur nga trupi. E dinte që e shoqja prej së keqes mallkonte shumë, i qëllonte fëmijët me mashën e zjarrit pranicave. Më pas i vinte keq përse e bënte këtë. Kthehej i merrte me të mirë. Bedriu nuk i fliste gruas. Që kur i kishin thënë «dyfekplasar» atij i dukej se edhe në shtëpi ishte i tillë. Kur nevrikosej, nuk u bërtiste as djemëve, as gruas, por dilte jashtë e bënte ndonjë punë sa t'i binin nervat. Atje

plaste «dyfekplasuri» e pastaj kthehej brenda, ku gjente fëmijët shtrirë buzë vatrës dhe gruan që i mbulonte me jorgan të vjetër...

E tani po ia zinte në gojë në këtë kohë të përbaltur kryetari. Ia përplasi para syve si pa gjë të keqe. Sytë e Bedriut digjeshin prej tymit, që urat e shtonin si me magji. Kryetari s'e prishte terezinë, mblidhej rreth pellushit të ngrohtë pa e ndier shiun në trup.

— Hë?! — vazhdoi avazin e vet kryetari.

— Çfarë! — foli i humbur Bedriu.

— Dyfekplasur do të mbetesh?!

— Më mirë dyfekplasur se sa i mbushur nga të tjerët, o kryetar, — dhe u ngrit të shmpinte gju-njët.

— Në dëm tënd është. Unë për të ndihmuar të thashë. Pse t'i marrë lekët një tjetër?! Merri ti. Ti i ke dhe kushtet për këtë punë.

— Le t'i marrë një tjetër, që e ka zakon në themel të shtëpisë. Dyfekmbushur fshati ka plot.

Kryetari u ngrit. Brenda trupit ishte valë i ngrohtë. Futi duart në xhepa dhe u bë gati për udhë.

— Më qafë paç veten! Të dolëm borxhit si njerëz që mendojmë për hallet e popullit.

— Faleminderit! — tha Bedriu i lagur gjer në paletë. — Do më mbulonit me borxhe mua dhe fëmijët e mi. Borxhe që s'do t'i laja dot kurrë.

— Je llafazan ti Bedri.

— Unë?! Edhe mund të jem. Ju i dini këto punë. I keni të shkruara të gjitha. Çëk, çëk e një më një.

— Kanë të drejtë vëllezërit e tu. Kjo mëndja jote kështu do të vuajë gjithnjë.

— Ee. Keq e më keq le të më shkojë.

— E shikon si je katandisur?! Kush do të kujdeset?

— Gruaja dhe perëndia.

— Mblidhe mendjen, Bedri. Të dëgjova të zësh edhe një herë pernëdinë në gojë, do t'u them atyre shokëve të të vinë e të hedhin hekurat.

— Perëndia do m'i heqë prapë.

— Mirë të ka mbetur «dyfekplasar», o i zi. Me ty s'merresh vesh, — përfundoi kryetari dhe ngjiti të përpjetën e arës, që të shpinte në fshat.

— Më mirë dyfekplasar se sa të më mbushin të tjerët, — ia ktheu përsëri Bedriu. Dhe nën zë mermëriti: «Mirë ia bëra. E?! E, mirë ia bëra, mirë. Le t'i shkruajë ai. Atë punë ka.»

Kryetari humbi shpejt në mjegullën e dendur. Punoi dhe gjysëm ore e pastaj mori rrugën andë nga do të vriste qenin pullali. Ai e ndiqte pas të zotit si e kishte ndjekur gjithë jetën. Donte edhe disa minuta të arrinte atje. Ndaloi hapat. I erdh keq ta vriste. «Eh, kusur! — psherëtiu. Pak më parë erdhën të më vrisnin mua. S'më vrau sot, mund të më vrasin nesër. Po unë s'jam mësuar të vras gjëkafshë. Pse ta vras këtë kafshë të shkretë?! Gjithë jetën më ruajti shtëpinë. Hajde o «dyfekplasar» hajde! Ktheu e lëre qenin të ngordhë vetë tek shtëpia, kur t'i vijë sahati. Më mirë nga perëndia se nga unë.»

Ndërroi rrugë. Shiu vazhdonte, balta shtoej. Mjegulla e ndiqte rrethuar nga mbrapa si qeni.

Nëntor 1991

## KAZILI

Përroska e vogël u turbullua nga rrotat e qerres ngarkuar me jonxhë. Vapë. Qetë dihasnin dhe shkumbzonin. «Ec! Ec, ore! Tërhiqe, edhe pak!» Zëri i qerreshiut të lodhur ngjante sikur u jepte qeve fuqi. Larushi plak tërhiqte me forcë e ishte thujse gjithmonë një hap para Kazilit, kaut më të fuqishëm që kishin parë ato fusha. Ata ishin çifti më i mirë. Qerrexhiu plak i shponte me keqardhje. «Hë! Hë, ore Kazil! Ndihamoje Larushin! Hë! Ashtu de!»

Qerrexhiu qëllon lehtë. Kazili, si ta kuptojë, tërheq qerren vetëm. Karrua lëkundet. Rrugës mbillen fiqe jonxhe. Shtypen guriçka të vogla. Kazili shkumbzon. Zverku i tij i rjepur e ka lëkurën të trashë. Larushi ndalet. Edhe kau tjetër. Qerrexhiu plak bërtet. «Hë! Or të uruar! Hë! Shtyhuni se kemi rruge të tjera!» Dielli djeg e të përvëlon. Përroska është lënë mbrapa. Gjinkallat shurdhojnë e grisnin ajër. Degët e rrapeve të përroit s'levizin gjekundi. Jargët e qeve varen si penj të hollë në tokë. Rrugaga ku qerrja ka ndalur është e përpjetë. Ajo tërheq pak qetë mbrapa. Shtiza e saj kërcet. Rrotat kuisin si angullima qenësh të lodhur. Zgjedha ngjeshet në shpatullat e qeve pleq. Qerrexhiu plak i mbytur në djersë, bërtet. Pastaj hidhet në tokë. Kapelja e vjetër i ka rrëshqitur. Koka i ha, si të jetë mbushur me mushkonja. E heq kapelen, por

dielli i përvëlon lëkurën e zhveshur si saç. U bër-  
tet edhe njëherë qeve të lodhur. Larushi tërheq  
pak. Lodhet. Lëkura i mblidhet pas shpatullave.  
Thundrat e këmbëve i janë hapur gati sa të fu-  
tësh midis tyre një grusht fëmije. Diku i përgja-  
ket lëkura e qafës. Turren mizat si të tërbuara e  
ia thithin të gjithë. Qerrexhiu vjen rrotull. «Hë?  
U lodhët? Po edhe këtë virane të përpjetme kemi,  
or të uruar!» Ai ka pesëmbëdhjetë vjet me Laru-  
shin e tetë me Kazilin. U fërkon kurrizin. U bie  
vitheve. Kazili mban peshën e shumtë. Larushi  
s'luan. Gulçon. Mizat vazhdojnë e pijnë gjak. Janë  
si tufë e harbuar, që gumzhijnë midis pushtetit  
zhuritës të diellit. Qerrexhiu u bie me pëllëmbën  
e ashpër e të madhe. Vret shumë, por s'mbarohen.  
Dora i përlyhet me gjak. E fshin dorën pas panta-  
llonave. Murriela, miza më të rritura e më gjak-  
sore, ulen në vithet e prapme të qeve e thithin  
gjakun e tyre. Larushi mbrohet me bisht. E lëviz  
shumë ngadalë, si të mos e ketë të tijin. Murrie-  
lat tremben, por edhe qerrexhiu fillon e merret  
me to. Jargët e tyre shtohen. Kazili i lodhur përr-  
mjer nga e keqja. Gulçon. Qerrexhiu ngjesh kapelen  
përsëri. U del para qeve. U fërkon ballin. Në anë  
të syve të tyre përsëri miza neveritëse. Ata më kot  
i trembin ndonjëherë me qerpikët e rënduar. Qer-  
ja tërheq nga pas. Të dy qetë marrin frymë me  
zor. Afshi i tyre i nxehtë del nga goja. Qerre-  
xhiu është mësuar e rritur me këtë afsh qeshë. U  
fërkon gongallat e fytyrës. Qetë njohin dorën e të  
zot dhe luajnë kokën sikur duan ta përshëndetin.  
Duart e qerrexhiut lahen nga jargët. «Hë, o Kazil!  
Do më japësh bukë edhe sot?! Do më ushqesh mua  
e dhjetë kalamajtë e mi?! Do ta nxjerrim qerren?»

Si thua?! Ti ke fuqinë në dorë! Edhe Larushi, edhe unë. Do të shplohdeni pak?! Po mirë, mirë!»

Kazili lëviz këmbët e prapme për të vrrarë murrilat. Ndonjëherë lëpihet me gjuhë. Larushi mbyll sytë, sikur bën gjumin e madh. «Hë! E mblodhët veten?! — fillon sërish qerrexhiu si kalojnë pesë minuta. E Larush, vëlla! Si thua? E provojmë njëherë?»

Ai u fërkon shpinat, vret mizat, tremb murrilat. Rreh me përkëdheli kurrizin e kafshëve, i fërkon me gishtërinj si t'i kruajë. «Nisemi tani! Hë, se në sahatin e drekës do t'u fus në lumë e t'u laj tek Varri i Gruas. Ju s'e dini ku është Varri i Gruas? Më mirë që s'e dini. Po unë do t'u shpie sot, o qerratenjë e t'u bëjë banjo. Hë, Larush, boll. Boll tani!» U bie të dyve në vithe. Qetë kuptojnë. Marrin fuqi. Qerrja lëviz, kërcet, rrotat kuisin. Qerrja bën pak përpara e qerrexhiu plak i vë shpatullat pas. E shtyn me sa fuqi që i ka mbetur, dhe bërtet: «Tërhiqe Larush! Jepi, o Zilo, se e nxorëm! Edhe pak!» Qerrexhiut i kërcasin zorrët në bark e i dhëmbin eshtrat e dërmuara. Qerrja nis të lëvizë ngadalë. Rrotat bëjnë një rrotullimë të plotë dhe qerrexhiu dërrmak nuk e ka hequr shpatullën e nxirë. Kapelja i ka rënë mbrapa e ai s'e ka ndierë. Tulla e kokës i është ngjeshur në jonxhën e ngarkuar mbi qerre. Edhe ai gulçon si qetë. Ndien se shpatulla i dhemb e i ther gjer në palcë. Shtyn, thërrret, gulçon, jep fuqi, pengohet e bie, ngrihet shpejt dhe mbështet shpatullën plagë e s'mallkon. Pas pak mbetet bosh. Ka filluar e tatënjeta dhe pesha e qerres shtyn qetë. Ai clirohet dhe fshin buzët e tharra. Në gojë mban një fill jonxhe dhe e kafshon ngadalë e me qejf. Clirohet. U gëzohet qeve si fë-

mijë. Larushi gulçon e lëshon jargë më tepër. Kur arrijnë tek stalla, ai ulet. Qerrexhiut dërmak i vjen keq ta ngrejë. Fillon e shkarkon. Kazili lëpin Larushin. Lëpin djersët e tij dhe e kruan me tur. Ajo është lodër e tyre e zakonshme. Kështu kruajnë nganjëherë njëri-tjetrin. Larushi var kokën mbyll sytë që ia ndyjnë mizat dhe nuk ha asnjë dorë jonxhë. Kazili me kokë të madhe e brinjë si harku i Odisesë, të mëdhenj e me majë, lëpin e lëpin djersët e kripura si të ketë nevojë vetëm për ato. Larushi e var më tepër kokën mënjanë e sikur dridhet. Kazili ulet e nuk lëpin më. Qerrexhiu plak merr trastën e bukës, ulet mbi kopicën e jonxhës e fillon të hajë. Një shishe shërbet sheqeri dhe gjysëm kokrrë domate të mbetur nga vakti i mëngjesit. Përtypet pak minuta e shtrihet të flejë, të marrë një sy gjumë. Heq shapkën nga koka, por mizat i sulen si re mbi tullackën e skuqur nga dielli. Mbulon kokën me jonxhë. Insektet e shumta i lëvrijnë mbi lëkurën e rjepur dhe s'e lënë të qetë. I pashpresë për ta freskuar kokën, ngjesh kapelen që binte erë djersë. Kalon kështu vetëm gjysëm ore dhe çohet. I bërtet Kazilit dhe ai ngrihet. Bërluket. Tund zverku, shkundet, tund kokën si t'i thotë të zotit plak se më ke gati dhe fillon të mbledhë me gjuhën e gjatë e të çjerrë jonxhë. Larushi mezi ngrihet. Dridhet. Nuk shkundet. As mizat nuk i tremb me bishtin e tij që i shkon gjer në fund të këmbëve. Murrielat thithin e thithin gjak mbi kurizin e kaut plak, në gjunjët, në vidhte, në shpatull, në lulet. Ai s'mbrohet. S'ka fuqi. Nuk i tund këmbët t'i trembë si dikur, në djalërinë e tij të fuqishme. Nië jetë të tërë i ka trembur fort me thundrat e tij të gjera, të rënda. Qerrexhiut plak i vjen



inat. I bërtet kaut që të bëhet i gjallë për veten e tij, por nuk e qëllon. Shtie vetë mbi murriela e miza të mëdha. Përlyen duart me gjak. Don t'i vrasë të gjitha, por ato ikin, tremben, fshihen e venë mbi Kazilin, që turfullon e shkundet si tërmet. Qerrexhiu plak fshin përsëri duart mbas pantallonave, ndez një të dredhur e niset me qerren për në lumë. U ka dhënë fjalën t'i lajë. Ai ua ka mbajtur gjithmonë fjalën. Ecën ngadalë. Nuk u shtie me shkopin e tij. Vetëm i shpon lehtë që të bëjnë udhë për në lumë. Dielli të bie në kokë. Kazilin e pickon zegali dhe harbon. Don të ecë si i tërbuar. Nis vrapin qeçe, por Larushi s'e ndjek dot. Shkundet qerrja. Rrotat kërcasin zevzeke. Trokashiten plaçkat e barkut të Larushit e Kazilit bashkë. Kau Larush s'mund të rendë. Edhe atë e ka pickuar zegali, i ka hidhëruar gjak e mish, por s'ka fuqi të rendë hakërryer... Mishhelmuar, gjak mbaruar ecën. Kazili s'rendi më. Turfullon kokën nën zgjedhë dhe i nënshtrohet fatit të keq. Kruhet, përplas këmbët dhe arrijnë në lumë. Qerrexhiu i ftoh me ujë, i kashait e i zbardh të gjithë. Ndonjëherë ndal duart tek lëkura e plagëruar, e tharë dhe shkërmoq me gishtat e plasaritur. Palët e lëkurës së zverkut janë aq të kalluara sa qetë s'ndiejnë asgjë kur ai ua thërmon.

Kthehet. I lëshon pak nga zgjedha e Larushi shkon nën lisat ku fle natën. Ulet. I lidh qetë, secilin më vete dhe bidonin me njëzetëepesë kile qu-mësht e shpie në krah, mbi shpatullat dërmake me pak kockë. Një kilometër larg. Atje u shplodh pak mendjefjetur, se qeve ua kishte mbushur grazhdin plot. Me rritësin e viçave këmbëjnë duhan duke ngrohur qumështin e viçave në kazan të madh. Die-

lli i korrikut, në prag të ngrysjes, djeg më pak. Gjinkallat vazhdojnë zhuzhunë e lodhshme. Qerrexhiu shikon viçat dhe mundohet të dallojë cila do të bëhet lopë e mirë dhe cili ka i parë për qerre që të zëvendësojë qetë e tij. Nuk i erdhi mirë kur mendoj ndërrimin e tyre. I vinte keq t'i këmbente me të tjerë. Çohet e me një frymë arrin tek qetë. Por ç'të shohë... Larushi është duke dhënë shpirt. Pëllet, pëllet e përpiqet, por s'ka fuqi. I bie këmbës. Fryhet. S'shkojnë as pesë minuta e shuhet fare. Sytë i ngrijnë. Qerrexhiu e di që s'e ka nga jonxha, por nga kush s'e kupton. Fillon e dridhet plaku qerrexhi. Bashkë me stallierët i presin kokën kaut shpirtpadhënë. Mizat turren të pijnë gjakun e mbetur. Qerrexhiu e largon Kazilin, si të jetë me zemër të dobët dhe mund ta zërë gjaku i shokut të vet. E lidh tek një lis i egër, që ka mbi supë një pjergull debinë. Era e gjakut të ngrohtë u përhap rreth e rrotull.

Qerrexhiu nuk vuri asnjë majë thike për të rjepur, se i vinte keq. Të tjerët e ripnin ngadalë e mishi zbulohet. Ripnin dhe rrëfenin historitë e Larushit, si t'i këndonin kuranin e fundit. Cila lopë e kishte bërë? Kur u zu për herë të parë në qerre me Verdhanin, kur mbante qerren me misër në të tatëpjetën e Cerovës, kur tërhiate më shumë se tetë quintalë jonxhë nga fusha e Kapllanit, kur nxorri një «Zis» ushtarak të mbetur në mes të lumit se nuk ndizej motori, kur zihej me qetë e tjerë pa u shtruar në qerre, kur...

Giersa u ron i gjithë dhe u pre mishi në katër pjesë të mëdha Larushi ishte gjallë, thuaise i gjallë nga rrëfimet e kasapëve të çastit. Natën Kazili e gdhiu jashtë, vetëm. Qerrexhiu i hodhi edhe ushqij-

min e Larushit atë natë. Kur u kthye të nesërmen roja i stallës i tha se Kazili kishte pallur gjatë gjithë natës e s'u pre fare. «Eh, i ziu, thosh qerrexhiu, s'gdhiet pa shokun e zgjedhës». Shkoi tek Kazili dhe e ledhatoi sa për të dy. «Eh, s'fjete ti e as unë s'mora një sy gjumë. Ke pëllitur tërë natën për shokun, unë kam psherëtirë tërë natën me gulç e s'mbylla sy. Të dyve na vjen keq për Larushin, o Kazo. Të dyve. Edhe Zinos sim pesëmbëdhjetë vjeçar, që u rrit me ju, i rrëfeva mbrëmë fatin e Larushit. Iku! Poo, ja. Mbetëm të dy.» Dhe ai i fërkonte kokën, zverkun, shpatullat, brinjët, kofshët, lulet. E fërkonte sa për dy. Kishte menduar se atë ditë do ta zinte në zgjedhë me Kombolin, një ka pak më të vogël, me një bri të thyer dhe tjetrin të varur mbi vesh. E zuri tek vendi i Larushit. Kazili i shkoi pranë dhe i mori erë te koka e te zverku, si t'ia shihte a e kishte të shëndoshë për punën e vështirë që bënë në qerre. Komboli hante pa ngritur kokën. Kazili u shkund i tërë, si të shkrydhej nga drobitja e natës së vetmuar. Qerrexhiu e zuri për veshi dhe e futi në zgjenë krah të tij. U foli të ecnin para, por Kazili s'luajti: I ra me shufër dhe filloi të lëvizte. Eci pak drejt, por pastaj ndërroi rrugë dhe u sul me vrap si i tërbuar. Komboli trup vogël mezi e arrinte. U rrotullua rreth stallave të mëdha dhe s'ndalonte. Komboli i shkretë shkumbëzonte i tërë, i zihej fryma. Kazili tani gati po e tërhiqte zvarrë. E ngjeshi pastaj te muri i mullirit me cekic. Komboli pëlliti me forcë se i dhembën brinjët. Këmbëshkurtër u hoq pak zvarrë. Kazili s'paskësh pikë mëshire, siç kishte për Larushin. Qerrexhiu i ndiqte djersitur nga pas me kapele hequr e tullackë zbuluar

duke mërmëritur pa frymë: «Ç'më bëre, o Kazil, ç'më bëre! Ç'më bëre o i zi, ç'më bëre! E pse më more në qafë?! E pse s'më the, o i zi që nuk e doje shok Kombolin?! Ç'më bëre, o Zilo, ç'më bëre?!» Gjunjëlodhur djesitej duke i ndjekur nga pas. Tek lisat mbi stalla, të dy qetë i ranë një lisi mes për mes dhe zgjedha me dru rrapi u thye. Qetë u ndanë. Komboli me një bri të thyer, me copën e zgjedhës mbi qafë dhe qepushinën lëkurë dhie, nuk pa nga shkoi. Rendi i trembur duke pëllitur, i tramasur për atë që ndjeu e hoqi. Kazilit, me gjithë atë fuqi që kishte marrë, s'i dilje dot përpara. Kur u thye zgjedha, si të kishte shpëtuar nga mortja, ndaloi dhe ecte shumë ngadalë. Qerrexhiu plak i doli në mes të rrugës dhe e ndiqte me sy. Kazili iu afrua dhe kur arriti tek këmbët e të zot s'hodhi asnjë çap më tej. Qerrexhiu i fërkoj zverkun dhe brirët e mëdhenj si harku i Odiseut, ballin e gjerë dhe pastaj i hoqi zgjedhën e thyer. Pas kësaj kau u kthye e shkoi tek vendi ku kaloi natën i vetmuar. Me sa dukej nuk kishte qejf të zihej në qerre atë ditë. U ul aty dhe filloi të pëlliste. U çua përsëri i mbushur me jargë. Shkoi disa metra më tej, atje ku u ther Larushi. Uli kokën dhe nuhati erën e gjakut. Gjaku nuk ishte përtharë ende mirë. Ai thithte e thithte duke gulçuar rëndë. Filloi të rrëmonte me thundra fort si të zbulonte burim gjaku. E ndjeu dhe e njohu që gjaku në atë tokë mbante afshin, frymën dhe erën e Larushit. Filloi të rrëmonte më shumë e dheu flakej mbrapa. Ngulte të dyja këmbët me forcë...

Qerrexhiu me kapelen e vjetër shkarë mënjanë vështron si i trullosur dhe buluritja rrëngethese gjithë afsh zëmërimi e Kazilit i ka qepur të flamo-

surën gojë. Dheu, që tani kish filluar të rrëmohej me bri, i dukej sikur shkulej e gërmohej nga shpirti i tij. Qerrexhiu afrohet te kau, kryqëzon duart mbas koke duke hequr kapelen fare. Fytyra i rru-dhoset më tepër, vetullat kreshpërohen dhe duket sikur ai bashkë me Kazilin kanë një dhimbje.

Kazili ulërin më fort. Duket se zëri po i humbet. Çjerr turinjtë. Ngul brirët me forcë dhe arrin të këputë rrënjë lisi. E ngul sërish, por rrënja e lisit është e fortë, e shëndoshë, e thellë. Briri i Kazilit mbetet mbërthyer atje dhe turiri i tij lëpin dhe. Buluritja mbytet gjëmueshëm. Luan kokën të nxjerrë bririn, por s'mundet. Kazili turfulton. Vapa ndizet. Qerrexhiu plak ngjesh e mbledh kapelen shuk në duart që i dhembin dhe i digjen. Mbi kokën lakuriqe i janë mbledhur dhjetra miza, por ai s'i ndjen. Buzët e përthara kërkojnë të lëvizin e të artikulojnë diçka me zë qetësues. Kazili sikur ha dhe. Lëkura e zverkut i varet e plagosur në tokë. Briri i harkuar ka mbetur ende nën rrënjën e lisit. Gjinkallat në degët e tij vazhdojnë avazin e mërzitshëm. Kazili dridhet i tëri. Mbledh forcat dhe i jep kokës fort. Kësaj radhe ajo ngrihet, por briri mbetet atje, ngulur mes rrënjës e dheut të zi. Kau e humbi një bri në betejën e zëmërimit të tërbuar. Ngjante sikur rrënja ishte një toreador dhe ai s'mposhtej. Nga copëza e bririt të mbetur rrjedh gjak që varet mbi sytë e kaut e pastaj për-zihet me dheun e rëmuar. Kazili merret me bririn tjetër. Qerrexhiu plak fillon e dridhet më tepër e mërmërit me vetë: «Ore viran! Po ç'bën, ore?! Ç'bën?! A e steh? E le bririn në dhe. Mos do të lësh edhe tjetrin?! Po të bie gjak, ore i vilanosur! Mjaft

më. Ulu! Shplodhu! Ç'ke që harbon? Do të hash? Ja të vete unë dhe të marr një krah». Shkon qerrexhiu e merr jonxhë. Kthehet e ia hedh, por kau s'ha. Nuk ia hedh sytë si dikur përkëdhelues, që ndalonte bërlykjet, përdridhte qafën, luante këmbët, lëpinte buzët me gjuhën e ashpër, ledhatonte lëkurën e tij me bishtin e gjatë. «Ha! Hë, ha tani! Lutet qerrexhiu. Të solla për të ngrënë. Është jonxha që sollëm dje nga Varrica. S'të hahet?! Po ç'ke, o i uruar?! Kërkon Larushin? Po iku ai, o derëzi, iku. Vate puna e tij. Mbaroi. Të la vetëm. E kuptove, o djall që mbete vetëm?! Po unë ta gjeta një shok, Kombolin. Atë që të zura në mëngjes. Pse nuk e qase, o i mirë. Në krah të Larushit e zura. Ka i mirë, parmende ishte edhe ai. Ka çarë gjithë ato brazda. Si ti e si Larushi nuk është, por më i mirë se të tjerët. Ti u harbove, Zilo dhe s'ma qase. Pse, oi shkretë?! Do të punojmë sot, apo jo?! Ti ha këtu, unë ha tek çanta ime, kalamajtë presin t'u shpie unë! Pa mua çdo të hanë? Hë?! Mjaft pëllite si i tërbuar! Ha pak!»

Qerrexhiu lutet kot. Kazili i harbuar nuk ia zgjat aspak gojën jonxhës. Ai e largon me buzët e jargosura e të përbaltura që përzihej me pika gjaku. Shtërngon muskujt, mblidhet lëkura. Gjakun ia thithin me dhjetra murriela, por ai s'turfullon për to. Koka i mbetet përsëri te rrënja e lisit e mbërthyer me bririn tjetër. «Do ta thyesh edhe atë, ore viran, duket sikur lutet qerrexhiu. Hiqe! Hiqe të kegen!»

Kazili si ta kishte mësuar heqjen përfundimtare, mblodhi gjithë forcën e muskujve të qafës, këmbëve, trupit dhe hakërreu me ulërimë tronditëse. Ngjau sikur u lëkund lisi, u trembën gjinkallat, u

tundën veshukët e rrushit të papjekur. U mblodh dhe u largua kruspull qerrexhiu. Dhe koka e Kazilit u ngrit lart me forcë. Edhe briri tjetër mbeti shkukur atje mes rrënjëve të ngatërruara të lisit. U thye krejtësisht harku i Odisesë. Kazili mbeti me ato pak brirë të përgjakur, që i kullonin më tepër. Pëllitja e tij u bë më e vajtueshme si një kujë e dhimbshme, e gjatë, që të dridhte çdo damar. Nuk merrej vesh për brirët e thyer e të humbur, për bukurinë e tyre, apo vajtonte klithshëm Larushin, që s'po e gjente as në dheun e rëmuar, as me ndihmën e pëllitjeve lodhëse. Jargët iu shtuan, gjuha po i varej jashtë. Buzët përdridheshin dhe vapa përvëluese sikur donte të thante para kohe butësinë e tyre. Qerrexhiut sa s'i çahej zemra. «Po tani, o Zilo?! Po tani, o Zilo me kë do të zihesh. Ku e ke, kapadaillëkun e brirëve tënd? E flake në hallet... Do t'u dalësh më përpara qeve të tjerë e të borroçitësh?! Dilu po deshe, por do t'i shtien zorret çarçafë mbërdhe. U bëre shyto!... Me çfarë do të mbrohesh?! Ha bajga tani!»

Ankimin e qerrexhiut plak, me shpirt dërmuar nuk e dëgjonte aspak. Avazi i tij bëhej i stërgjatur edhe më keq. Qerrexhiu tashmë e kuptoi. Kazili kërkonte shokun e vet, Larushin, Kërkonte ta zbulonte nga dheu i rëmuar, nga gjaku i përballtur, nga afshi i mbetur i tij. Larushi s'dukej më. Kazili u lodh. Iu prenë gjunjët. Thundrat iu mbushën në hapsirën boshe me dhe. Ulet mbi to. Mbështet kokën mbi rrënjët që mbajnë brirët e thyer. Damarët e qafës i janë këputur krejt. Jargët kullojnë, këmbët e lodhura shtrihen, bishti nuk lëviz fuqishëm.

«Shplodhet, — mendon qerrexhiu plak e kthe-

het pas të ndezë një duhan të fortë me të dredhur. Trungu i lisit ia fsheh pak Kazilin, por ai është disi më i qetë.

Thithi cigaren fort e kruajti kokën. Ka harruar se dielli ia ka skuqur pak si tepër lëkurën. E kruan me gishtërinjtë e ashpër e pastaj e ngjesh përsëri kapelen bojëdalë që të kundërmon në erë djersë. Ndien pëllitjen e dobët të Kazilit, që sa vjen e rrallohet. Dhe pas pak nuk ndihet. Qerrexhiu qetësohet më shumë. Mbaron duhanin. Ngrihet e shkon drejt Kazilit t'i afrojë jonxhën për ta ngrënë. Kau s'leviz fare. Gjaku vazhdon t'i rrjedhë nga brirët. Këmbët i ka shtrirë. Bishti i ka mbetur mbi bark e nuk lëviz. Qerrexhiu afrohet më tepër. «Hë, Kazil! U lodhe?! Mirë! Miirë! Sot nuk po të zë! Shplodhu, o byrazer, shplodhu!»

I shikon brirët, shikon gjuhën kafshuar. Kau s'mer frymë, sytë s'kanë dritë të ndezur, koka nuk lëviz, qepallat nuk mbrojnë dritën e syve si të shuar e të vrarë. Ai ka ngordhur. Gjaku vazhdon të pikojë e të njomë rrënjën e lisit të madh. Qerrexhiu përkulet dhe i mbështet dorën mbi kokën e djersitur, mbi buzën e lyer me dhe të përzier me gjak. Ia mbylli sytë si të ishte njeri dhe shikon me keqardhje, si të mos ketë ngordhur akoma. Pastaj qerrexhiu kujtohet se nuk po ia dëgjon më fare dihatjen, as lëvizjet e barkut. . . Ngrihet në këmbë e i bie kokës me grushta dhe buza e poshtëme fillon t'i dridhet e para, pastaj trupi dhe nuk duron dot. Duket se do ta zërë era e gjakut. Kazilit i duhet prerë koka. Ai asnjëherë s'ka therur në jetën e tij. Ikën me kapelen bojëdalë të lajmërojë stallierët. Mbi Kazilin pa jetë u turrën mu-



rrielat. Ai nuk mbrohet më. Gjinkallat vazhdojnë avazin. Dielli djeg nga ana tjetër.

Qerrexhiu s'punoj as të nesërmen. As më vonë. Aq sa filluan të mos e quanin qerrexhi. Ai kishte thënë se dora e tij nuk do të ngjiste më kurrë pendë tjetër veç atyre që ngordhën për njëri-tjetrin. Tre ditë më pas qerrexhi shkoi tek vendi dhe mori brirët e kazilit. Do t'ia jepte një plaku t'i bënte murut thikash, t'i mbante për kujtim.

Qershor 1991

## TINGUJ PËR T'U VRARË

I veshur me zbukurimet e festës, qyteti i ftonte njerëzit në rrugë. Thuhej se do të mbusheshin edhe vitrinat. Në disa pika të dukshme dritat e ndezura të krijonin përshtypjen e ndjekjes së njëra-tjetrës për të krijuar errësirën larg. Por në mbrëmje ajri freskohet më tepër. Njerëzit lëvizin ngadalë për të mos humbur edhe këto pak orë me diell. E nesërmja nuk dihet. Gjithmonë e nesërmja nuk dihet. Për një çast duket se kështu mendojnë të gjithë dhe s'duan të falin asnjë minutë të çastit që duket se po i lumturon në stinën dimërore, në pragun e festës që thuhej se do të bëhej. Disa të veshur mirë, disa më pak, disa të rreckosur, që fshehin duart thellë kofshëve të tyre, se edhe një xhep nuk e kanë të saktë. Të tëra palët shëtisin e dritat ndizen sipër kokave të tyre si vetëtimë, pa dallim se kë kënaqin e kujt i nxjerrin lakuriqësinë e papërfillshme. Dikush loz me trajektorët e dritave dhe fantazon, dikush shpin damarët e qafës...

Nga turizmi i vjetër i qytetit del një burrë i veshur keq, i parrojtur e me një tufë gazetash për të shitur. Në krah mban thesin e përhershëm të letrave. Nuk është i thyer në moshë, por ka një krrusje të tepërt të shpinës dhe fytyrë të drobitur. Gojën e mban gjysmë të hapur, si të ketë

lindur ashtu dhe sytë i ngjajnë paksa të çakërdi-  
sur e gjithmonë vështrojnë të lodhur e të paku-  
ptimtë. Ata ngjajnë fatkeqë, sikur nuk do të jenë  
mbyllur kurrë për të fjetur rehat. Rrobat e vjetra  
i ka gjithë njolla e të palara. Buzëqeshja e tij  
është e pakët, e frikshme, shtegtuese dhe me ndje-  
njën se nga çasti në çast ajo e qeshur do t'i mba-  
rohet dhe ai do të ndodhet mes një boshllëku lumtu-  
rie për të tjerët. Ka vite që ai jeton me qytetin dhe  
qyteti jeton me të si me mospërfillje. Vjen pak es-  
mer, por nuk është jevg dhe megjithatë jevg i  
thërrasin. Ai nuk zemërohet për këtë. Për të s'ka  
rëndësi në është i zi apo i bardhë. Ai vetë shihte  
turli njerëzish. Edhe jevgjër që lexonin gazeta më  
shumë se të bardhët, edhe të bardhë që ishin  
budallenj për të, se nuk zgjasnin dorën për të blerë  
një gazetë. Kështu i shtyn ditët gazetshitsi. Ecën  
rrugëve e në vend që të lypë drejt për drejt u lutet  
njerëzve të blejnë gazetat e tij. Thërret.

— Blini gazeta!

Njerëzit ngjajnë mospërfillës dhe pak e shikojnë.  
Gazetshitsi stis buzëqeshjen, por ata kanë kaluar  
pas shpinës së tij dhe s'e kthejnë më kokën.

— Kanë lajme të mira, — shton ai. — Blini kë  
të doni! Kam gazetat e të gjitha partive. Shkruhet  
për bllokun! Filloi greva e urisë. Flitet për ndih-  
ma! Premtohet për qetësi! Botohet një petition!  
Shahen ministrat! Blini gazeta! Partitë shajnë njëra-  
tjetrën! Do t'i blini?!

Shitsi i gazetave nuk di të lexojë. Ata që e  
dinë këtë buzëqeshin, ata që s'e dinë habiten dhe  
kur vështrojnë gazetën që e kanë lexuar dy ditë  
më parë e nuk kishte asnjë lajm të mirë, tërhiqen,

e kuptojnë hilenë. Shitësi i gazetave vazhdon me një zë më të ngjirur, si këlthitje.

— Blini gazeta! Jan të sotme. Kësaj radhe i kanë ngulur edhe presidentit. U mbaruan gazetat.

Gjysmat e tyre gazetshitsi i ka fshehur në thes. Të lodhur, njerëzit i lëshojnë para duarve ndonjë lek dhe ikin pa marrë gazetën. Të tjerë e marrin nxitimthi e për të plotësuar boshllëkun i japin pa buzëqeshje që e dehin gazetëshitësin vetëm për atë çast.

Ai ecën përpara. Diku e tërheqin tingujt e një muzike ëmbëlsuese. Atëherë ndal hapin e shpejt dhe ul kokën për të ngritur veshët. Muzika e përhumbe nën tingujt e saj melodiozë e ai qesh me vetveten. Është gati të lërë thesin e letrave, dëngur e gazetave që i kanë mbetur pa shitur dhe të kërcëjë. Bën disa lëvizje këmbësh në kuadrate pllakash si të jetë i dehur. I lëshon plaçkat se është dehur me të vërtetë. Atij i erdhi ora e paardhur. Ora që do të ikte pa e pyetur atë. Fillon e kërcen. Ngre duart lart, kërcet gishtërinjtë. Ngre kokën. Qielli, tej në perëndimin e largët, ndriçohet nga rrezet e fundit ngjyrë portokalli të diellit, që vezullon si i paarrtshëm. Gazetashitësi ka dëgjuar sikur do të bëhet festë nga të tjerët, por e dallon edhe nga një pjesë e dyqaneve që janë mbushur nga zbulimet, vrapimi i dritave të shtuara për të mos lejuar mbërritjen e errësirës. Tingujt, si në rinat, e dehnin çmendurisht. Ai e do çmendurinë e dehjes muzikore. Tingujt vrisnin orët e ndyra të jetës së pështirë, vrisnin minutat pa frymëmarrje, vrisnin atë. Ai s'e kishte pranuar vrasien. Vazhdon e kërcet gishtërinjtë e thatë, të verdhë e nak si të murrme si një kore toke e papunuar. Shikon

nga perëndimi, ku dielli po fshihet me përflakjen e zbehtë. Damarët, të ndezur e të pakomanduar aq shumë, sikur i nxehen. Diçka mërmërit dhe fjalët «Zot i qiellit! Oh zot i madh!» sikur shpërthejnë nga kufijtë e mundimit. Lart bashkohen dy krahët e tij dhe gishtërinjtë shtrihen sikur duan të presin diçka me thikë. I ul duart mbi kokë dhe vështron dritat që vrapojnë mbi një dyqan plot kukulla, më tej dyqanin për gjërat që dalin në ditë festash të tilla. Njerëzit hyjnë, blejnë, dalin, qeshin, shëtisin. Ka të veshur mirë edhe keq. Ka me xhepa plot, por edhe pa xhepa. Gazetashitësi, nga këta të fundit do që të ketë më pak. Të paktën të jetë vetëm ai e qyteti të mos lodhet me të tjerë. Por ai e di që për qytetin nuk është i vetëm. Ka plot që zënë qoshet. Shitësi i gazetave ende nuk e ka mbushur xhepin që të hyjë në dyqan e të blejë gjërat e festës. Ndërsa të tjerët hyjnë e dalin për të blerë, ai ka harruar. Tingujt e muzikës vazhdojnë ta dehin ëmbëlsisht e barbarisht. Këmbët kanë dalë jashtë kontrollit e jashtë kuadratit të pllakave dhe padashur pengohen. Pengohen apo ai dehet jashtë mase nga tingujt muzikorë, që vrisnin orët e trishtuara?! Bie. Çuditet që është penguar tek dëngu i gazetave. I ka përshkelur dhe i fshin me pëllëmbën e hollë dhe të verdhë. Rrethi tij janë grumbulluar disa fëmijë. Ai vetë s'ka fëmijë, s'është martuar asnjëherë. Por fëmijët i do. I do shumë. U buzëqesh. Ata qeshin dhe tregojnë me gisht këmishën e tij të murrme. Një këmishë ushtarake që nuk e mbante mend kush ia kishte falur. Apo... Dhuruar?! Jo. Ia kishin dhënë për hakun e punës. Nga stacioni i trenit kishte marrë mbi shpatullat e dobta dy valixhet

e një çifti plazhist. Burri i kishte dhënë si shpërblim këmishën me jakë të ngrënë e me bërryla të holluar. Nuk mbante mend sa kohë e kishte veshur atë. Fillimisht e mbante veshur mbi rrobat e tjera. Kur u gris e mbuloi me një të vjetër po të trashë. Ashtu ato mbulonin njëra-tjetrën.

Qeshnin fëmijët me gishtat e vegjël, drejtuar mbi trupin dërrasë të tij. Këmisha zbërthyer, zbulonte një kraharor gjithë lesh, por të dobët e të flashkët. Gishtat e fëmijëve buzëgaz sikur e nxisnin të lëvizte këmbët më shpejt se tingujt që shlodhinin shpirtin e tij, mund të mbaronin. Edhe dritat vrapuese i thoshin çohu, edhe vezullimi i zbehtë që po zhdukej fare. Një çast, vetëm një çast ai nuk përfilli asnjë. Mori inat me të gjitha nxitjet që i bëheshin dhe si të ishte i paralizuar nuk bëri asnjë lëvizje. Fëmijët ikën. Ikën të gjithë. Askush nuk po kujtohej të blinte gazetën. Gazetëshitësi u këputi një të sharë nënë atyre që i shtypnin. Për të ata e kishin fajin. Po të shtypnin gjëra të mira, të gjithë do t'ia blinin. Të gjithë. Po çfarë shkruhej, nga të tjerët i mësonte. Vetë nuk lexonte kurrë. Ishte neveri për të. Mori një ndër duar dhe e shfletoi. Dikush e pa me gazetë të hapur dhe buzëqeshi djallëzisht. Hapja e gazetës ishte me kokë poshtë. E mbylli dhe e bashkoi me të tjerat. Harroi se një melodi tjetër muzikore pat filluar. U ngrit dhe filloi të kërcente me dehjen e qëparshme. Mund të shtynte orë të tëra ashtu. U djersit. Këmbët i hidhte si i marrë. I shtoej një gëzim i brendshëm, që arrinte gjer në kufij të pakapshëm. Këpucët e shtrëmbëra pengonin lëviziet e tij të pakta, energjike. që kërkonin një harmoni midis tingujve dhe shpirtit. I hoqi dhe filloi një kërcim disi

më ritmik. Iku radha e trokut të këpucëve të vje-  
tra. Ishte ajo e çorapeve që binin erë djersë. Për-  
mbi lutjet e zotit, si për dëshirë të tij, muzika  
shtoi tingujt e ai shtoi ritmin. Shpirti sikur po qe-  
tësohej dhe ai harroi se për në mbrëmje s'kishte  
mbledhur as gjysmat e lekëve të zakonshme. As  
këtë natë nuk do ta kalonte si të tjerët me gjëra  
të mira. Pranë tij erdhi një djalë i vogël, i bukur  
si ëngjëll. I veshur me pulovër e gëzof dhelpre  
të punuar me kujdes, ecte si në ëndrra e ndali pa-  
ra tij. Nga gjithë qënia i dukej vetëm fytyra dhe  
ca flokë që i binin mbi ballë e gjer mbi vetulla.  
Dy sy të zez që përshkëndijonin nga ngazëllimi i  
kërcimtarit. Faqet e kuqe, që i fryheshin pak kur  
qeshte, buzët e holla, që mblidheshin e zbulonin  
dhëmbët e tij të bardhë. Mjekrën e vogël ia mbu-  
lonte herë pas here gëzofi. Burri që kërcente i  
mbante sytë vazhdimisht nga qielli. «Oh, Zot! Oh!  
Zot!» mërmëriste dhe ritmika ia nxehu shputat e  
këmbëve. Fëmija filloi ta shodëronte në mënyrë  
imituese. Ai nuk ishte as pesë vjeç. Kërcenin të dy.

Vogëlushi, prej larg shodërohej e kontrollohej  
nga një çift që ngjante krejtësisht i lumtur e pa  
halle. Ata ndiqnin të dy gëzimin e fëmijës dhe rri-  
nin pak larg. Gruaja e re ndjente bezdi e neveri  
t'i afrohej jevgut gazetshitës e i palarë. njeri rru-  
gësh. I shoqi kundërshtonte si me frikë koketën  
e tij. Mbronte me frikë gazetshitësin dhe sgaro-  
nte se gëzimi i fëmijës është i pakontrollueshëm.  
Ai e gjeti vetë atë çast, atë mikroskenë dhe vetë  
do të shkëputet prej saj kur të lodhet. Gruaja e re,  
që anonte më tepër nga nusia, përdridhte buzët  
me shumë kuides, miklonte trupin, shtërngonte du-  
art mbi gjoksin e bëshëm si ta ruante nga ndonjë

sy i keq. Gazetshitësi kërcente më tepër. Filloi një melodi tjetër më gazndjellëse, më ritmike, më shploodhëse. Uli kokën dhe iu drejtua fëmijës kur pa që edhe ai po kërcente me këmbët e vogla që s'ndiheshin aspak mbi pllakat e tortuarit. Burri kërcimtar thujse u çmend fare. Gjetei një shok kërcimtar. Nuk ishte vetëm atë çast. Atë e donte një fëmijë, që nuk e kishte parë asnjëherë. I vinte rrotull duke kërcyer dhe përdridhte trupin si asnjëherë. Fytyra e tij engjëllore i ngjante Zotit. Burri ngriti duart. Edhe vogëlushi bënte ashtu. Burri rrotullohej, edhe fëmija rrotullohej. Gazetshitësi kërciste gishtërinjtë, edhe fëmija kërkonte të imitonte. Gishtërinjtë e hollë e të zverdhur të burrit lëshonin pak zhurmë, ndërsa të fëmijës aspak. Ata ishin të butë, të njomë dhe vetëm sa skuqeshin kur shtrengoheshin me njëri-tjetrin. Vogëlushit i erdhi inat dhe i shtërngoi gishtërinjtë më fort. Ndalo kërcimin për të mësuar lëvizjen e gishtave. Burri e pa dhe e la veprimin e gishtrinjëve. Edhe fëmija ashtu bëri. Filloi rrahja e shuplakave. Fëmija imitoi. Burri i afrohej, përkulej gjithnjë e më tepër mbi vogëlushin engjëll të bukurisë. Te sytë e tij lodërtar sikur shikonte një dritë përçuese të pambarimtë. Njerëz të tjerë filluan të shikonin «dy valltarët» që hidhnin këmbët bukur edhe me muzikë të largët. Një horr i gjatë nga trupi, nga ata të zakonshmit, që ka çdo qytet, kërkoi të pengonte burrin e dehur nga tingujt e mbrëmjes. Por dikush e mbajti për krahu. Horri kafshoi cepin e buzëve dhe u vërenjt. Kërkonte të bënte një rreng tallës, që burrin-fëmijë ta nxirrte nga vallja rome, që ai e hidhte si të kishte mbaruar me dhjetra kurse për këtë, a sikur të kishte kërcyer gjithë jetën nën



pushtetin e atyre tingujve. Fëmija dha shenja lodhje e u skuq në fytyrë. Ai qeshte me burrin dhe i zgjati dorën e vockël. Gazetshitesi ia preku me kujdes, si të prekte një dorë mrekullie të jashtëzakonshme, një pastërti të larë nga vet zoti. Puthi dorën e vogëlushit dhe ia ledhatoi butësisht. E mbështeti në faqen e parruar dhe të ndezur shumë. Gruaja, që nga bukuria anonte më tepër me një nuse të re, u bë furtunë në fytyrë. Ia bëri me dorë fëmijës të largohej prej jevgut.

— Ia bëri dorën pis, — i tha të shoqit.

— Nuk ka gjë, — përgjigjet i shoqi. — Ata të dy janë të lumtur, — vazhdoi i shoqi.

Gruaja e bukur u çudit. «Të lumtur»?! Do t'i ngjitet fëmijës ndonjë sëmundje nga ai! E shikon si i ka buzët?! Gjithë pështymë të përtharë anash, që të ngjall krupën. Oh, zot, sa i pistë ai njeri. Po e thërras fëmijën».

I shoqi mudohej të përmbante gruan me arsye-time pedagogjike, që ajo s'i fërshëllente aspak. Muzika vazhdonte t'i lodhte të dy kërcimtarët. Duke u mbajtur në duart e njëri-tjetrit rrotulloheshin. Fëmija gazatohej i gjithë. Ishin çaste të lumtura për të dy. Pragmuzgu thyhej. Pas pak dritat do të ndizeshin më tepër. Horri që shikonte burrin kërcimtar, përfundoi ndërkohë planin e djallëzisë për ta shkëputur nga kërcimi magjepës plakun-burrrë.

— Plako! Më jep një gazetë! — dhe nxori një pesëlekëshe të re duke e përkëdhelur në duar si milioner. Burri kënaqej me fëmijën.

— Mbaji të gjitha lekët, — tha horri tallës. — Të gjitha. Mua më jep vetëm një gazetë. Vetëm një. Hajde, plako, mos më vono.

Burri kërcimtar i dëgjoji të gjitha, por nuk e

prishi vrullin e çastit të vogël lumturor. Megjithëse ai e dinte që çasti do të kishte një fund, përsëri nuk donte. Horri kafshon anën tjetër të buzës së trashë,

— Do të më japësh një gazetë, o matuf, — thirri më fort horri dhe futi një dorë në xhep.

— Nuk kam, — tha burri gazetëshitës nga e keqja. — Nuk kam. I kam shitur të gjitha. Të gjitha i shita.

Tingujt romë e dehnin dhe e dehnin vazhdimisht.

— Po ato?! — vazhdoi horri.

— Ato?! — tha burri duke mos e ndalur kërcimin që i sillte lumturinë. — Në to nuk shkruhet asgjë. Kot. Kot që i blen. Mos i harxho paratë. Nuk kam asgjë për të shitur. Ik! Ik mos tharto trutë kot, — dhe iu kthye vrulltaz vogëlushit: «Hopa! Hopa qerratuc!» Kërcenin të dy. Vogëlushi u lodh së tepërmi e u ul një cast mbi thesin e përlyer të letrave, duke shtuar të qeshurën nga ngacmimet e burrit që s'lodhej aspak. Burri që ishte fillikat, pa fëmijë, pa grua, pa vëllezër, pa motër. Burrë për të gjithë e burrë për asnjë. Vogëlushi filloi të rrihte pëllëmbët sipas ritmit të këmbëve kërcimtare. Pastaj fëmija u ngrit. U shlodh. Gazetëshitësi u marramend dhe i përmbajtur e puthi fëmijën në ballë. Kërkonte t'i ledhatonte flokët dhe i hoqi kapuçin. Fëmija u gëzua më tepër. Flokët e treguan se ishte vajzë. I kishte shumë të rritur dhe iu përhapën mbi supet e vogla gjithë bukuri. Burrit kërcimtar i rrëshqitën disa pika lot. Ai qan. Pse qan?! Askush nuk e kuptoi. Fëmija nuk i kuptoi lotët. Ai zgjati gishtat e vegjël dhe i fshiu lotët burrit esmer.

— Mos qaj, xhaxhi! Unë jam këtu. Të kam xhan! Nuk do të iki. Lotë janë këto, xhaxhi?!

Gazetshitesit po i dridheshin duart mbi flokët e fëmijës. Çifti i fëmijës i quajti lot gëzimi; ata që i shihnin më nga afër lot lodhjeje të zgjatur. Lagështirën mbi mollëza e fshiu me duart e zbeh-ta. Puthi edhe njëherë fëmijën dhe një pikë lot u rrëzua mbi flokët e zez të vogëlushes. Ia largoi flokët dhe e puthi në ballin e vogël. «Kjo nuk durohet më, — foli e ëma e vogëlushes. — Vajzës do t'i ngjitet ndonjë sëmundje. Do të shkoj ta marr!» «Prit! — foli i shoqi dhe e mbajti për krahu. — Fëmija gjeti shok për të luajtur, burri gjeti një njeri për të harruar vuajtjet. Së paku një çast. Së paku pesë minuta. Ne pesë minuta kemi. E shikon ku është katandisur ai njeri? Pastaj fëmija tani është i lumtur.» Gruaja heshti duke mërmëritur diçka nën buzë dhe lëvizte këmbët me nervozizëm.

Muzika u pre. Vezullimi shpirtëror i gazetshitesit vazhdonte. Ai kërcente sikur melodinë e mëparshme ta ndiente vetëm ai dhe askush tjetër. Njerëzit përreth filluan të largoheshin, duke mos dashur të lodheshin më me budallallëkun e tij. Burri kërcente. Ai ndjente muzikën e padukshme. Vetëm ai.

— Ai është i çmendur! — tha gruaja që anonte për nga bukuria me një nuse të re. — Muzikë s'ka e ai kërcen. Është i çmendur! — përsëriti!

— Jo, — tha prerë i shoqi.

— Atëherë i dehur.

— I dehur?! I dehur vetëm nga muzika.

— Ata tinguj duhen vrarë, — nxiti nëna e vajzës.

— Tingujt s'vriten kurrë, — mbrojti burri.

— I vret heshtja, — zgjaste bisedën ajo.

— Edhe tani ka heshtje, — ia kthente ai i vendosur. — Përse nuk janë vrrarë?! Përse?! E shikon? Ai vazhdon e kërcen. Ato s'i vret asgjë. Shikoje si kërcen?! Ai është me të vërtetë i dehur. Dehja vjen pas pijes, apo jo?

Atë çast gazetashitësi ndali lëvizjen e këmbëve. Ishte djersitur i gjithi dhe merrte frymë me zor.

Vogëlushja u tremb se mos i ikte kërcimtari dhe nxori nga xhepi një vegël të vockël kauçuku, që po t'i fryeje lëshonte disa tinguj muzikorë. Vogëlushja filloi t'i frynte dhe dolën tinguj të dobët. Nuk ishin si ata që dëgjoheshin disa çaste më parë, por burri filloi kërcimin sërish. Fëmijës iu shtua gazi dhe nxirrte herë pas here dhëmbët e bardhë jashtë. Harroi t'i binte veglës së saj muzikore, por burri kërcente dhe vështronte «veglën muzikore» në gojë të fëmijës. Ajo ngjante me një revolver. Ç'modelist kishte qenë ai që derdhi këtë instrument muzike për të përcjellë tinguj?... Burri kërcimtar u çudit. Sikur ta kishte kuptuar, ndali lëvizjen e këmbëve. Vogëlushja kishte futur në gojë grykën e revolverit — muzikë dhe e qeshura nuk dilte e gjithë. Gishtërinjtë e saj ishin shtërnguar tek këmbëza e armës-muzikë. Vogëlushja s'po i frynte, por shtërngonte me dhëmbë grykën e saj prej kauçuku. Megjithëse filloi të dëgjohej përsëri melodia e mëparshme rome, gazetshitësi nuk lëvizi. Shikon vogëlushen i trembur dhe ngrin çdo lëvizje të trupit. Ngrin buzëqeshja, stampohet fytyra, s'lëviz mjekrra, s'dridhet buza, s'kërcasin gishtërinjtë, s'lëvizin sytë, asgjë. Por kjo ndodh ve-

tëm tek gazetshitësi. Për rreth, gjithçka vrapon si më parë. Njerëzit hyjnë, dalin nëpër punët e tyre. Askush nuk e vë re ngrirjen momentale të burrit. Askush nuk e kupton magjinë e shpirtit të tij. Prindrit e vogëlushes e mendojnë si pjesë të kërcimit të tij. Fëmija si plotësim i dëshirës së vogëlushes. Muzika romë zgjatet e ëmbël si më parë, por burri nuk kërcen aspak. Këmisha e vjetër ushtarake i është zbërthyer e gjithë. Trupi i lehtë ngjan sikur është rrënoqethur i gjithë. Vogëlushja e pafajshme me grykën e revoles në gojë qesh dhe fytyra e saj kërkon që burri të vazhdojë kërcimin si më parë. Burri ngre vetullat lart, fryn bulçitë e dobëta, ndez damarë zemërimi dhe nuk e përfill muzikën që e dehu çmendurisht. Shkrihet si i rrëmbyer dhe ulet përballë fytyrës së vogëlushes. Shtërngon duart e zverdhura me thonj paprerë dhe grushti i tij ngjan i pafuqishëm. I zë duart vogëlushes dhe rrëmbehet në veprim. I heq nga goja revolverin muzikë, e shikon pak çaste para syve të tij e pastaj gati çirret. «Mos! Mos!».

Fëmija hesht.  
— Mos bli muzikë të tillë. Kjo të vret. Ai ia rrëmben nga duart dhe e përplas me forcë në trotuar. Nuk thyhet. Burri e shkeli me inat, ajo rrëshqiti më tej. Vogëlushja nuk kuptoi asgjë dhe sytë e bukur i mbushi me lotë. Gruaja s'u përmbajt, u shkëput vrullshëm prej të shoqit.

— I çmendur! — thirri pranë tij dhe rrëmbeu vogëlushen në kraharor të mbytur në lot.

Gazetshitësi e vështroi i habitur e gojëkyçur. Gruaja u përkul të merrte lodrën e fëmijës, por gazetshitësi u tregua më i shkathët dhe e shkeli më parë. «Ajo u thye.

— I çmendur! I çmendur! Budalla! Idiot!

Burri fatkeq nuk foli. Vështroi revolverin-muzikë dhe i erdhi keq. Ajo i vrau tingujt.

— Pse e theve? Budalla! Idiot! — vazhdoi gruaja. Burri gati sa nuk qau. Nxorri një grusht para të mbledhura gjatë ditës dhe ia hodhi gruas para këmbëve si shpërblim që i theu armën muzikë- vrasëse. Nuk i foli. I buzëqeshi vogëlushes që nuk e pa sepse kishte zhytur kokën në gjoksin e nënës së vet. Paratë mbetën në trotuar. Të gjithë i thërrasin. Gruaja vazhdonte ta shikonte me inat. Gazetshitësi shkundi xhepat. Nxori edhe një pesëdhjetë qindarkëshe të vetme. Ia la gruas në heshtje, rrëmbeu thesin e palarë të letrave, tufën e gazetave dhe u shty mes errësirës, pa mbërthyer këmishën e vjetër ushtarake. Rregulloi xhepat e boshatisur. Ajri pak i ftohtë i funddhjetorit rrihte kraharorin e zbuluar dhe filloi refreni i kollës së thatë e të rëndë. Askush s'po blinte gazeta atë natë...

**Mars 1991**

## REFUGJATI I SAJ

Klubi i vogël ndodhej larg zhurmës, nga ana veriore e qytetit të vogël. Nuk bëheshin më tepër se gjashtë tavolina. Dy nga fundi ishin bashkuar dhe flisnin pranë tyre pak të kujdesshëm. Vetë isha ulur me Pashon e rrëfeshim pranë gotës së rakisë. Ai ishte disa vite më i madh se unë, por mu habeti na haej shumë me njëri-tjetrin. Ai jepte letërsi në gjimnazin e qytetit, ndërsa unë në fshatin tim të lindjes. E kishim kthyer nga një teke dhe po pinim kafetë. Folëm pak për letërsinë, sidomos për romanet e fundit dhe pastaj ai u sulmbi mua s'e ç'bëja për jetën e mëpastajshme. A kisha menduar për një vajzë, a do të mbetsha der-vish?! Nuk i thashë shumë fjalë, bile mundohesha të bëja një lloj shmangie. As s'e kisha në xhep letrën e një gjimnazisteje, që ai i jepte mësim. Isha gjithë trazuar, katrabujë në shpirt dhe këtë mund ta jepte vetëm vështrimi disi i përmbajtur dhe i qetë i syve të mi. Gjimnazistja e tij shkruante vargje. Ne ishim njohur rastësisht e më pas u afruam kur shkuam në qytetin e Korçës në një takim talentesh. Më pas njohja jonë vazhdoi dhe ajo më postonte vazhdimisht poezi t'ia shikoja, megjithëse këtë punë mund ta bënte edhe Pashua, që drejtonte rrethin letrar të gjimnazit. Unë isha diçka më afër botës së saj, iu duka më romantik; beqar isha dhe midis nesh falej një mospërmbajtje me

iluzione romantike. Ajo shkruante më tepër në vargje të lirë dhe për ato kërkonte edhe ndonjë mendimin tim. Një poezi që mbytej me të përnirë. Për atë ajo më kërkonte që në përgjigje t'i thosha se kishte apo jo origjinalitet poezia. U gjenda midis dy hamendjeve. Ishte dhënë ajo vajze e bukur, e thjeshtë? Qe puthur dhe nga afshi i nxehtë i saj rrahu vargjet? Apo askush nuk i kishte shijuar buzët e saj dhe ajo, si ëndrrimtare, kishte të drejtën të sajonte puthje, të ndizte zjarr përvëlues dhe pastaj të më pyeste mua nëse ishte origjinale. Ende nuk i kisha kthyer përgjigje, se edhe mund të shkoja me Pashon nga gjimnazi dhe ajo atje mbate më priste. Vargjet e puthjeve ishin mbjellë tani nga unë në buzët e filxhanit...

— Marrim edhe nga një teke?! — lutet Pashua me zërin e tij pak të hollë e të çiltër.

Harroj të përgjigjem dhe më dukej sikur lëpija vargjet në buzë të filxhanit, që lëshonte avujt e nxehtë të kafesë.

— Ej! Ku të fluturon mendja?!

— Askund, — gënjeva duke mos dashur t'i nxirrja përplasjet e shpirtit tim gjer në fund, sepse ruajtja e një misteri brenda vetes, ndonjëherë edhe të shlodh.

— Marrim edhe nga një teke?! — përsëriti ai.

— Marrim, por kësaj radhe nga unë.

— Mos më çaj kokën! Sa të jemi këtu... e kam unë hesapin. Kur të vijmë atje, përgjigju t'i gjer më një.

Qesha mbi kafënë e zezë të papërfunduar. Ai porositi teket që s'vonuan të vinin. Ndërkohë kisha hedhur njëherë sytë mbi tavolinat e bashkuara dhe



filxhani i kafes më ngriu në dorë. Harrova ta shpija tek goja.

— Ç'pate?! — u çudit shoku.

— Ai djali atje, — fola me pak zë dhe tregova me kokë. Pashua ktheu kokën.

— E, mashkull është.

— Nuk e kisha aty, por...

— Aha! Refugjati i parë i qytetit tonë.

— Refugjat?!

— E pra. A nuk është pak e vështirë t'u thuash njerëzve refugjat. Diçka neveritëse kjo fjalë, a nuk do të shkonte më mirë mërgimtar. Kjo jep një shfaqje më poetike, por edhe nga ana leksikologjike njihet me qëndrueshmëri.

— Po ti ku e njeh? — pyeta edhe njëherë Pashon.

— Po është nga qyteti ynë. Më duket se sot shpall fejesën. E shikon?! Është veshur me rrobat që ka sjellë nga Greqia.

— Ai shpall fejesën?!

— Poosi. Merre gotën e rakisë tani!

Mbaja ende filxhanin e kafesë së zezë në dorë. Refugjatin, që mbase e njihja dikur më mirë se Pashua, kisha një të drejtë ta urreja, por meqënëse ai po e shpallte fejesën edhe mund ta qetësoja pak veten. Shoku ktheu gotën dhe i hodhi sytë refugjatis.

— Ka pesë ditë kthyer dhe sot shpall fejesën me një gocë nga qyteti.

M'u dridh dora dhe kafja u derdh mbi mbulesën e bardhë.

— Ç'pate?!

— Harrova se e kisha në dorë. Kjo dreq dorë e djathtë më mpihet shumë shpejt.

Ai tundi kokën me mua, ndërsa i buzëqeshi djalit refugjat, duke i shkelur syrin.

— Po kjo?! Kjo fejesë kaq shpejt?!

— Vajzë e një urregtari të qytetit. Ai po ndërton një klub privat. Merre gotën e mos e vra mendjen shumë.

Eshtë më tepër një çështje filantropike. Tipa si ai i gjurmojnë këto raste.

Pashua fliste ndërsa unë shpërndaja të zezën e kafesë mbi mbulesën e bardhë të tavolinës. Atë djalë pothuaj e njihja mirë. Kishte punuar një muaj në Bamas si mekanik dhe ishte marrë atje me një edukatore kopshti, një esmerkë bukuroshe, që kishte ca linja trupore të mahnitshme, midis bukurisë adhuruese dhe asaj ekzaltuese. Dikur esmerkën e kisha dashur edhe unë me të vërtetë, para refugjatit, por nuk e kuptova më pas se ç'rrukopujë ndodhi në qënien e saj dhe u largua nga unë. Unë kurrë s'u kam premtuar femrave gjëra të bukura. Tek qënia ime gjithmonë kërkoja të shfaqesha vetëm ashtu si isha. Ajo ishte fantastike në ëndrra dhe rendtë drejt modernes, e cila mund të gjendej vetëm në qytete të mëdha. Mbase kjo lindi rrokopujën. Së bashku me punën që na largoi dhe kur shkova pas disa kohe për të rifilluar lidhjet tona ajo ma preu shkurt. I kish dhënë fjalën një djali tjetër nga qyteti. I fola gjatë atë ditë në ndërtesën e kopshtit. U përlot. Dreqi e di se si m'u ndodhën atë ditë ato fjalë magjike nga shpirti dhe e bëra për të qarë. Nxori fëmijët e kopshtit jashtë të mos ia shihnin lotët. Se ç'mbante një shamizë të vogël në gishtërinjtë e hollë dhe fshinte më të mallë qerpikët e syve, që u ngjanin liqeneve të bukur malorë. Në ndarje e urova që ai

djalë ta bënte më të lumtur se unë. Kjo ishte dëshira ime, pa djallëzinë më të vogël, sepse nuk doja që ajo bukuri të vuante. Ndiqja mendimin që për bukurinë të gjithë duhet të bëjmë diçka. As të mos i poshtërojmë e as të mos i përshkelim me cinizëm. A nuk janë të rralla ato dhe rrallë mund t'i falë natyra? Kështu i kisha thënë asaj dhe s'desha që të vinte tek unë vetëm pse e doja. Të hynte nëse më donte e në të kundërt le të më mjaftonte kjo njohje që u thye. Ajo e mbajti veten dhe buzëqeshi në çastin që dy sumbulla lot i mbetën mbi mollëzat e faqeve. Duart ia kisha zënë unë me të miat. Në çast m'u duk e lumtur. Iu afrova për ta puthur dhe ajo s'lëvizi fare. «Qofsh e lumtur!» — e urova me gjithë zemër. «Faleminderit!» — u përgjigj ajo me tisin e bukurisë që nuk i mungonte asnjëherë. — «Ai do të më bëjë me të vërtetë të lumtur!» Ishte takimi i fundit. Kur u ktheva, më ndoqi një shi i tmerrshëm. Nuk dija se ç'dhimbje shpërbëhej atë ditë: lotët e saj, zemërimi im, apo një ndarje e magjishme që s'duhej të ndodhte. Më duket se edhe unë qava atë ditë, por lotët e mi të kripur nuk i ndjeva ngaqë shiu s'm'u nda gjer sa arrita në shtëpi. Nuk pyeta më për atë vajzë. E lashë në krahët e lumturisë, që kish gjetur vetë. Një ditë e përgjova pak çaste në festën e çlirimit të qytetit. Mbase dilnin për herë të parë. Dukej e lumtur. Unë i buzëqesha nga larg, i gëzuar që ajo ishte e lumtur, por buzëqeshja ime humbi. E dalloi ose jo, nuk arrita ta përcaktoj, veç ajo ishte indiferente për njerëzit që e rrethonin. Mes atij rrethi isha dhe unë. Nuk kishte asgjë e s'e vrisja mendjen për gjëra të tilla. Më vonë më kërkoi t'a ndihmoja për një problem. Rrezikohej ta

hiqnin nga puna dhe unë ndërhyra tek një kuadër pushteti, që e kisha shok dhe ajo s'levizi prej anej...

— Gëzuar! Hë! — më përmendi zëri i Pashos.

— Gëzuar! — thujse mërmërita.

— Rerugjatit s'po i pritet, — vazhdoi Pashua, — sa të vijë miqtë me gjunë vajzën. Sot bëhet zyrtare, — dhe qeshi.

— Ai më duket si i shastisur, — thashë me një lloj nervozismi, që thujse po më pushtonte të tërin.

— Jo. Ç'ne. Me sa kam marrë vesh unë ka mbi një muaj që është hapur ky muhabet. Ti e di që qyteti ynë është i vogël dhe... As qytet s'është ky yni. Grumbull pallatesh të mbushur me njerëz. Qendra është atje, afër fshatit tuaj. Ne jemi biçim rajoni, por që shtohemi më tepër se ju. Mbledh, mbledh uzina jonë e nesër do të bëhemi më tepër se vetë qendra. Hajde gëzuar!

— Gëzuar!

Refugjati u buzëqeshte nga pak njerëzve të vet dhe hunda e tij e madhe më dukej se kapte mbi tavolinë. Pinte cigare të jashtme e tymoste me finësë. Ai njeri kishte lexuar gjysmat e poezive të mia dhe letrat që ia pata dërguar Linditës. Kishte marrë guxim të tallej me ato e më pas i kish thënë vajzës që më mirë t'i digjte vetë. Mos të merrej me pallavra mësuesish. Ata janë të lehtë, ndaj edhe turku nuk i thërriste si dëshmitarë nëpër gjyqe. Ajo i pati premtuar se do t'i digjte, por s'di se ç'bëri. Refugjati nuk më njihte si fytyrë. Si emër po. E ç'rëndësi kishin emrat? Pa të askush s'ka mbetur. Që kur mora vesh historinë e djegjes së letrave m'u neverit ai njeri si mashkull, ai re-

fugjat që mbannte veshur rrobat e xhelozisë.

— Ja, erdhën, — më zgjoi Pashua si të më kishte zënë merakun për ata.

Ngrita kokën pa kureshtje të madhe. E dija që Lionda, siç e përkëdhelja unë, nuk do të vinte. Ajo mbase ato çaste u tregonte përralla me ujqër të këqij e të zez fëmijëve të kopshtit atje në rrëzë të malit të Tomorrit dhe fëmijët e veckël ndiqnin përrallëzën pa ia ndarë sytë si copa kaltërsish...

Karriket lëvizën me pak zhurmë, mermëritje fjalësh. «Urdhëroni! Urdhëroni! Jo, jo! Ju uluni aty! Ashtu! Edhe ju këtu! Pooo. Po çifti?! Çifti?! E? Ata? Çifti të rrijë në këmbë, tha dikush me zë të trashë. Joo, u hodh një i tretë. Ka vend edhe për ata.»

— Rregullohuni! — u duk se dha urdhër dikush që për vete që ngrefosur mirë në krye.

— Duhet një karrike, — foli një grua pa u ulur vetë.

Pashua me sa dukej i ndiqte më me interes veprimet e tyre.

— Ka këtu, — i foli shoku im.

— Pres një shok. — ndërhyra unë nga inati dhe i vura karrikes dorën përsipër pa pyetur se ç'bëhej andej nga fundi.

Pashua u çudit dhe ngriti vetullat.

— Vërtet?!

— Po.

— Shiko se...

Ata gjetën karrike tjetër dhe u qetësuan duke vazhduar përshëndetjet e zakonshme. Pashua ndiqte ritin e veprimeve të tyre.

— Gëzuar! — thirra unë e kapa gotën që ta ktheja të gjithën.

— Hë, de! Mirë që u bërë i gjallë.

Lashë pak në fund të gotës.

— Nuk të erdhi ai shoku?!

— Jo. Bëra shaka.

— Shaka?!

— E. Nuk më pëlqeu ai tip refugjati, — ia preva shkurt.

Pashua mblodhi pak supet dhe vazhdoi:

— Rraca jonë e letrave duhet të jetë më njerëzore. Apo jo?

— Natyrisht! — mbështeta unë duke thithur erën e rakisë. — Por është edhe më e trazuar. Trazimet tek ne janë nga më të çuditshmet, Pasho. Ne kemi misteret më të pakuptueshme.

— Po kjo?! — dhe tregoi gotën. — Kjo ç'bën?

— Kjo të heq vargonjtë e druajtjes, që mund t'u vësh fjalëve të shpirtit kur je esëll.

— Bukur! Po kur rrumbullakosesh?!

— Sigurisht, — thashë unë. — Edhe nga guri buroftë.

E kthjem edhe njëherë. I kërkova cigare Pashos dhe ndezëm të dy. Tek dera u shfaq një bashkëfshatar i Linditës, mësues në fshat të saj. M'u duk sikur erdhi një frymë e saj, një grusht ajër prej malit, një copë freski e ftohur me borë. Ai s'na vuri re. Me sa dukej kërkonte vend bosh dhe jo njerëz. Si nuk pa tavolina, bëri të dilte. I thirra. Bëhej kohë pa e parë dhe të dy u gëzuam shumë. Shumë pyetje ia bëmë njëri-tjetrit në këmbë aq sa harruam Pashon që rrinte vetëm. U takua edhe me të.

— Ulu! — i thashë.

— S'jam vetëm, — ma ktheu ai dhe qeshi. Jam me gruan dhe një shoqe tjetër.

— Le të vijnë! Akoma rrinë? — i ftova me gjithë zemër, se kërkoja ta kapërxeja atë çast turbullimi që më shkaktoi refugjati.

Ai hyri vetë i tretë. E para e shoqja dhe e dyta... Oh, kush ishte e dyta?! E pabesueshme. Erdhi gjithë ajri. Freskia e ftohtë me borë të pastër. Ishte vetë Lindita. Përshëndetëm njëri-tjetrin. Ajo ishte dobësuar pak dhe më erdhi keq. E pyeta për njerëzit e shtëpisë dhe për veten e saj më pak.

— Tre kafe usta! — u tregua i gatshëm Pashua.

— I kam unë, Pasho sepse janë të njohurit e mi, — ndërhyra në çast.

— Jo. Kafet i kam unë, — ndërhyri Lindita.

— Po më gjetët këtu, — vazhdova.

— Nuk ka asgjë. I premtova Xhelalit dhe të shoqes. Sot mora atestimin e shkallës së dytë si edukatore kopshti.

— Domethënë përrallat i tregon më bukur tani, ë? — Ajo buzëqeshi me kujdes.

— Prandaj qerasja më takon mua, — vazhdoi ajo.

— Nga unë s'do të merrni asgjë?

Pashua heshtte.

— Njëherë tjetër, — ndërhyri Xhelali.

— Ty po të jap një dopio raki, — e ndërpreva dhe u ngrita në këmbë.

Ai s'kundërshtoi më. Solla dhe tri raki të tjera. Ndërkohë erdhi edhe kafja.

— Në dasëm! — më uroi Xhelali.

— Pas Linditës. — thashë duke qeshur pa djalëzi. Ajo uli sytë mbi filxhanin e kafesë.

— Kur të kthehet nga Greqia, — sqaroi e shoqja e Xhelalit. Ka shkuar refugjat.

Nga ata të tre askush nuk e dinte se ai qe kthyer dhe se ndodhej në ato çaste në të njëjtin klub me ne.

— Ai i letrave? — pyeta me takt Linditën. Ajo pohoi me kokë.

— Më vjen keq, por ai është kthyer, — foli unë.

— Kur? — pyeti e shoqja e Xhelalit.

— Gëzuar, Xhelal! — mora gotën unë. Nxitoj!

— Luajte mendsh?! — ndërhyri Pashua. — Harrove që do të shkojmë nga gjimnazi?

Nga tavolinat e fundit zërat sikur u zgjuan. Dikush mërmëriti fjalët dhëndër e pastaj emrin e plotë të tij. Lindita ktheu me kujdes kokën anej dhe u drodh. Gjer atëherë nuk e dinte se ai ishte brenda e kurorëzohej si dhëndër. Dridhja qe pak e zgjatur dhe asaj i ra filxhani nga dora, ashtu si mua pak më parë. Koka i mbeti anej, ndërsa ata nuk e kishin aspak mendjen te ne. Refugjati me të bijën e tregtarit ishin ngritur në këmbë dhe prisnin urimet e të dy palëve me tundje kokash. Fjalët «Të trashëgohen» e «Faleminderit» u ngulën disa herë si gozhdë te Lindita. Ajo zu të dridhej e nxorri një shamizë të vogël si atë të lotëve dhe fshiu buzët.

— Qenka dita e filxhanëve të derdhur sot! — tha Pashua.

— Pse? — pyeti Xhelali.

— Ja, këtu, para se të vinit ju iu derdh këtij, — dhe tregoi me dorë nga unë.

Lindita e dëgjoi shumë mirë e më vështroi si dikur.

— Filxhanët që mbajnë kafe të zezë, — shtova unë i ardhur pak në qejf. — Kafja e zezë pihet



në çdo sebep, Pasho. E di apo jo? Disa e pijnë të ëmbël, disa me pak sheqer, disa të hidhur.

— Këtu bëjnë kafe të mirë, — mbrojti Pashua. E shoqja e Xhelalit e kuptoi dehjen time dhe i shkeli këmbën Linditës, ndërsa nga ana tjetër i dha një shenjë të shoqit. Pashua kapi njërën dorë si të më shihte pulsën.

— Jam i qetë, — i thashë. — Vetëm kafja...

Në të vërtetë pak shumë e kisha mendjen të kafja. Lindita ishte zverdhur e tëra. I dridhej buza e poshtme. Pashua e shihte me bisht të syrit, por më tepër më mbante dorën mua tek pulsi, ndërsa me tjetrën gotën e rakisë. Xhelali na kujtoi t'i shkundnim gotat, ndërsa Lindita të çoheshim. Na dhanë dorën.

— Po u përcjell tek dera! — u thashë dhe i kërkova leje kolegut.

— Më fal! — tha ajo pas derës dhe te gishtërinjtë e saj më la njolla të zeza kafeje.

— Më vjen keq që ndodhi kështu, — foli unë si i përhumur.

Asaj i buruan lot.

— I dogje letrat dhe poezitë e mia? — pyeta unë:

— Jo. I fsheha. Eja merri kur të duash.

Ajo iku e unë u futa brenda me njollat e kafesë në duar. Porosita edhe dy teke të tjera. I mora në banak vetë dhe u ula.

— Ç'bën? — tha Pashua.

— Më pihet sot.

— Po ti s'ke pirë ndonjëherë kaq?

— Sot dua të dehem, — dhe hapa pëllëmbët mbi tavolinë si të dorëzohesha pa kushte.

Nga fundi u shtuan zërat, lëvizën karriket.

— Po dalin, — tha Pashua dhe i shoqëroi me një lloj lumturie sikur të ishte shpirtërisht në ritin ceremonial.

— Refugjati apo emigranti, si e the?! Apo mërgimtari?!

Pashua buzëqeshi.

— Mërgimtar. Ana leksikologjike e pranon më mirë. E njeh?

— Po. E njoh dhe më pëlqen ta quaj me emrin e rëndomtë rrefugjat, pavarësisht se s'do të ma pranojë leksikologjia shqipe. Ky njeri, deri para tre-katër muajsh ishte i fejuari i asaj vajzës që iu derdh filxhani i kafesë. E shikon sa e ka nxirë mbulesën e bardhë kjo kafe e zezë?!!

Pashua i mbërtheu sytë mbi kafenë e derdhur, ndërsa unë puthja vargjet e gjimnazistes në gotën e rakisë...

## PERMBAJTJA

SA PAK RRON NJERIU .....	3
BAKUA .....	16
RAKIA DILTE E MIRË .....	23
NESËR, NË DRITËN E DIELLIT .....	37
NATA E VETME .....	48
DYFEKPLASURI .....	58
KAZILI .....	69
TINGUJ PËR TË VRARË .....	82
REFUGJATI I SAJ .....	94